




POEZI PËR REZISTENCË  
DHE LIRI

Mahmud Dervish



© LOGOS·A  
S H K U P  
PRISHTINË  
T I R A N Ë  
2 0 1 3



LOGOS·A

Mahmud Dervish  
POEZI PËR REZISTENCË DHE LIRI

Boton: LOGOS-A  
Biblioteka: DIVAN

Për botuesin: Adnan Ismaili  
Kryeredaktor: Husamedin Abazi  
Redaktor biblioteke: Milazim Krasniqi

Redaktor artistik & diseni: Edib Agagjyshi  
Redaktor teknik: Naser Fera  
Mbikëqyrës i shtypit: Kemal Ismaili  
Përgatitja kompjuterike: Focus Pro - Shkup  
Shtypi: Focus Print - Shkup

ISBN 978-9989-58-474-9

[www.logos-a.com](http://www.logos-a.com)

Copyright©Logos-A, 2013

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.  
Ky libër mund të kopjohet pjesërisht për përdorim personal dhe jofitimprurës. Kjo rekomandohet për qëllime promovuese të librit apo edhe për afirmim të kulturës së leximit në përgjithësi. Por, nuk lejohet riprodhimi, transmetimi apo kopjimi i këtij libri në tërësi pa lejen paraprake të Logos-A.

# POEZI PËR REZISTENCË DHE LIRI

Mahmud Dervish

E PËRKTHEU NGA ARABISHTJA:  
Dr. Abdullah Hamiti

TITULLI I ORIGINALIT:

قصائد للمقاومة و الحرية

للشاعر محمود درويش

(Kasaid lil-Mukaveme ve-l-Hurrijje)



D I V A N

"Të jesh poet është vështirë,  
të jesh poet palestinez edhe më vështirë"

*Mahmud Dervish*

## PËRMBAJTJA:

PARATHËNIE .....	9
MAHMUD DERVISH POET I IDENTITETIT DHE I REZISTENCËS PALESTINEZE.....	9
MOMENTI LAMTUMIRËS.....	21
KITARISTI ENDACAK .....	23
PËR DËSHIRAT.....	25
THA KËNGËTARI .....	26
ZËRI DHE KAMXHIKU .....	28
KËNGA E ROBIT .....	30
LINDJA.....	32
FOTOGRAFIA NË HORIZONT .....	33
NDJESA .....	34
PREMTIMET E FURTUNËS.....	35
MOS MË BRAKTIS .....	36
MOS FLEJ E DASHURA IME.....	37
SHI I IMËT I NJË VJESHTE TË LARGËT .....	39
I HUAJI NË QYTETIN E LARGËT .....	41
HËNA E DIMRIT .....	42
I FRIKUARI NGA HËNA .....	44
FTESË PËR KUJTIM .....	45
POEMA VAJZAT E TROJËS .....	46
PËRSËRI.....	47
QYTETI I OKUPUAR .....	49
KALIMTARI .....	50
HAPAT NË NATË.....	52
MË DUKET SE TË DUA .....	54
POEMA PËR TOKËN .....	56
I KTHYERI NË JAFË.....	59

FYELLI .....	62
E DIELA E KALTËRT .....	63
PËR MBRËMJEN E FUNDIT .....	65
ASHTU THA DRURI I HARRUAR .....	67
KUNDËRSHTIMI .....	69
TRENI I ORËS NJË .....	70
POZITA E VETME E SHUMË MARINARËVE .....	72
HINGËLLIMA E FUNDIT .....	74
NJERIUT .....	76
DHE U KTHYE NË QEFIN .....	77
TRI FOTOGRAFI .....	81
SHPRESA .....	83
TAKIMI I PARË .....	84
KËNGA .....	86
PËR REZISTENCËN .....	87
LIDHSHMËRIA .....	88
PËR POEZINË .....	89
RUBAIRAT .....	91
KORRIKU DHE GJARPËRI .....	93
BURGU .....	95
TELEGRAM NGA BURGU .....	96
ME MUHAMEDIN .....	97
PJESA E MBETUR E POEMËS .....	98
E PAMUNDURA .....	99
POEMA E BURRAVE .....	100
IMPROVIZIMI NË UJË .....	104
KOPSHTI I FJETUR .....	107
RITA DHE PUSHKA .....	111
ZOGJTË VDESIN NË XHELIL .....	113
NJË POEMË .....	115
NË SHKËMB HINGËLLOJNË KUAJT .....	116

<b>KËTU JEMI NE .....</b>	<b>117</b>
<b>NGA CIKLI FYEJT .....</b>	<b>119</b>
<b>LETËRNJOFTIMI .....</b>	<b>140</b>
<b>REAKCIONI .....</b>	<b>143</b>
<b>NËNËS SIME .....</b>	<b>144</b>
<b>URA.....</b>	<b>145</b>
<b>FJALA.....</b>	<b>149</b>
<b>LETËR NGA MËRGIMI.....</b>	<b>150</b>
<b>TË VRANË NË LUM.....</b>	<b>155</b>
<b>AHMED ZAATAR.....</b>	<b>164</b>
<b>I DASHURUARI NË PALESTINË.....</b>	<b>171</b>



## PARATHËNIE

### MAHMUD DERVISH POET I IDENTITETIT DHE I REZISTENCËS PALESTINEZE

Të përcillet krijimtaria letrare arabe është mjaft vështirë sepse sot me këtë shprehje nënkuptojmë veprimtarinë letrare që krijohet në 22 vende arabe plus palestinezët pa shtet të tyre të mirëfilltë, të cilët kanë një gjuhë të njëjtë letrare që sot për sot ndoshta është i vetmi medium që i bashkon arabët e ndarë mes veti në kufij shtetëror e me regjime e sisteme të ndryshme shoqërore. Dhe si pasojë të kësaj ndarjeje të arabëve, në këtë rajon të botës vazhdimisht kemi vatra krizash që me decenie nuk po zgjidhen, e ndër to pa dyshim se çështja palestineze është më primare. Prandaj palestinezët gjithnjë janë të pranishëm në shtypin botëror ku shkruhet për intifadën e tyre të cilët orvaten t'i kthejnë territoret e tyre të pushtuara me forcë nga Izraeli. Por, krahas luftës për liri te palestinezët ekziston edhe një veprimtari e begatshme kulturore e cila, pothuaj sot, te lexuesit e mbarë botës është më e njohur se krijimtaritë letrare të vendeve të tjera arabe, e kjo bëhet falë disa krijuesve palestinezë të cilët me veprat e tyre letrare kanë krijuar emër jo vetëm në botën arabe por edhe më gjerë. Ndër të tillët është edhe Mahmud Dervishi\* i cili nuk lindi si ndonjë yll e as që shkëlqeu përnjëhe-

- Është lindur në vitin 1941 në fshatin al-Barva, afër qytetit palestinez Xhelila. Nga vendlindja u largua më 1948 kur izraelitët e rrënojnë atë fshat dhe kështu e shlyejnë nga sipërfaqja e tokës. Bashk me prindërit e merr arratinë, pastaj vendosen në një kamp refugjatësh në Liban, por më vonë sërish kthehet në

rë, por megjithatë talenti i tij prej poeti u vërejt në moshën shumë të hershme rinore kur filloi të merret me poezi dhe se poezitë e tij ishin të afërta me të gjithë brezët e lexuesve, e dalngadal pastaj e përsosi edhe stilin që sot të konsiderohet ndoshta edhe poeti më i mirë palestinez, e mbase edhe ndër poetët më të mirë arabë bashkëkohorë.

Megjithatë, është e pamundur të shkruash për një poet palestinez pa e përshkruar së paku në pika të shkurta poezinë palestineze të ashtuquajtur poezi e rezistencës. Kjo për arsye se tragjedia e kohës të cilën po e përjeton populli arab-palestinez reflektohet në këtë poezi, madje në një mënyrë dhe masë më të madhe se sa do të mendonim ne në shikim të parë, sepse poezia tek arabët gjithnjë ka qenë e edhe sot është si art më i dashur. Për këtë arsye termi Poezi e rezistencës si duket në tërësi i përshtatet natyrës së kësaj poezie dhe flet qartë për drejtimin themelor të angazhimit të saj. Për kohën kur lind kjo poezi, ka supozime të ndryshme, sipas disave ky zhanër i poezisë lind

Palestinën e okupuar. Një kohë të gjatë merr pjesë dhe bashkëpunon me grupin letrar "El - Erd" (Toka) të cilit më vonë organet izraelite ia ndalojnë aktivitetin Për shkak të aktivitetit të tij revolucionar e letrar pushtuesit izraelit disa herë e burgosin, kurse më në fund e detyrojnë ta braktias Palestinën. Kështu, që nga viti 1971 jetoi nëpër vende të ndryshme arabe, pastaj në Bejrut i inkuadruar drejtpërsëdrejti në revolucionin palestinez. Ishte pjesëmarrës i dramës së përgjakshme të Bejrutit në verën e vitit 1982 kur izraelitët bënë invazion në Liban dhe pastaj bashk me udhëheqësinë e OÇP-së u detyruan të largohen nga Bejruti për të vazhduar të jetoi nëpër vende të ndryshme arabe. Mbase për shkak se që nga moshën shtatë vjeçare jetoi si refugjatë duke u endur nga një vend në vendin tjetër, por pa shtëpi të veten, gazeta palestineze "Falestin al-Thevra" e patë quajtur "Poet me valixhë". Një kohë ka jetuar edhe në Paris, ndërsa viteve të fundit ka jetuar dhe ka vepruar në Bregun Perëndimor, në Ramallah dhe pas një operacioni në zemër vdiq në Amerikë më 2008 dhe u varros në Ramallah me nderimet më të larta shtetërore. Ishte fitues i disa çmimeve ndërkombëtare për poezi, ndërkaq në vitin 2006 ishte në listen e kandidatëve për çmimin Nobel për letërsi.

nga koha e themelimit të Izraelit si shtet 1948, por varianti tjetër më i përhapur thotë se poezia e rezistencës fillon viteve të gjashtëdhjeta të shekullit XX, përkatësisht fillon me organizimin dhe masovizimin aktiv të rrezistencës së palestinezëve kundër gjenocidit izraelit. Dhe si term ky emërtim vje nga poeti i ndjerë palestinez Gasan Kanfani, të cilin e vrau pushteti izraelit, e i cili më 1969 e boton librin e tij të shquar *"Letërsia e rezistencës në Palestinën e okupuar"*. Sido që të jetë, ajo formohet në formë të tillë si vetëdije revolucionare e cila në mënyrë epike e shpreh luftën palestineze për ruajtjen e identitetit dhe drejtpërdrejt kontribuon intensifikimit të rezistencës në territoret e okupuara, pra kjo poezi me rolin e saj të pamohueshëm të komunikimit emotiv tek arabët shumë preکشëm e përshkruan tragjikën e kohës të cilën po e përjeton me dekada të tëra populli arab - palestinez.

Një ndër karakteristikat e poezisë së rezistencës është arabizmi i potencuar fuqimisht. Kjo poezi, si e tillë, paraqet formë të posaçme të rezistencës aktive, jo vetëm kundër Izraelit, por edhe ndaj të gjitha përpjekjeve të orientuara kundër unitetit arab, në radhë të parë kundër atyre forcave që luftojnë kundër unitetit gjuhësor të arabëve që daton që nga shpallja e Kur'anit, gjuha e të cilit sot e asaj dite është si gjuhë letrare e të gjithë arabëve që konsiderohet si unitet shpirtëror i arabëve. Prandaj, kur Mahmud Dervishi klith: *"Shkruaj unë jam arab"*, nuk synon vetëm kërcënim por, aludon edhe në anën tjetër të pasqyrës së aksioneve vrasëse të arabizmit në Palestinën e okupuar të cilën në të vërtetë e shpreh poezia e rezistencës me fjalët e saj të zgjedhura. Kjo është vijë e saktë në konfirmimin e arabizmit, e kjo njëherit është pika themelore e kësaj poezie. Pushteti izraelit pikërisht vetëdijen kombëtare, identitetin e historinë është

munduar t'ua humb arabëve në trojet palestineze dhe duke e parë rolin e madh të poezisë për arabizmin gjithnjë i ka ndjekur e torturuar krijuesit intelektual, sidomos ata krijues letrar autentik në territoret e okupuara. Mbase këto i ka pasur parasysht Mahmud Dervishi kur ka deklaruar: *"Të jesh poet është vështirë, por të jesh poet palestinez edhe më vështirë"*. Prandaj trajtimi i temës së identitetit, ekzistencës, të qenunit të Mahmud Dervishi është shumë i pranishëm në gjithë krijimtarinë e tij. Edhe kur flet për fëmijërinë, edhe kur trajton peizazhin, punën, por edhe kur flet për luftën e për dashurinë ndihet atmosfera e të qenunit, ekzistencës dhe e identitetit kombëtar. Kjo është pra ai indi kryesor që shtrihet nëpër të gjitha poret e poezisë së tij. Dhe mbase kjo e ka bërë poezinë e Mahmud Dervishit poezi gjitharabe me vlera të larta, por që ka edhe vlera univerzale. Sepse trajtimi i tragjikës njerëzore, dhe qëndrimi i drejtë i poetit për njeriun i kalojnë caqet kombëtare. Poeti, flet sh lirë e pa inferioritet për identitetin e tij, dhe ai vetëm don të trajtohet si njeri, e të jetoj i lirë e i barabartë.

Por poezia e rezistencës i përballon të gjitha këto dhe ajo e ushqen moralin e heroizmit dhe shpreh domosdonë e rezistencës, ajo është nxitëse e aksioneve dhe bashkon rreth një qëllimi të vetëm të palestinezëve - për pavarësi dhe liri. Kjo poezi me të gjitha elementet e veta lidhet me realitetin e tashëm dhe të ardhshëm historik të arabëve dhe me të gjitha komponentat nacionale dhe popullore. Të gjitha elementet njerëzore dhe atdhetare lindin nga rëra, gjethi i portokallit e i ullirit, nga arat e grurit, nga lindja dhe perëndimi i diellit, nga gëzimi dhe hidhërimi, nga rrëfimet dhe përrallat, kurse njerëzit janë burim i të gjitha këtyre duke i përdorur që rezistenca të bëhet qëllim i tyre të kthehet kënaqësia e këndhsme e kaluar

duke e harruar të tashmen, prandaj edhe Mahmud Dervishi shprehet:

*Atdheu im është kasaphane  
Në të isha muzikant u bëra tel kitare  
Kur isha i vogël e i lumtur  
Lulja ishte shtëpia ime  
Përrenjtë ishin deti im  
Lulja u bë plagë  
Përrenjtë gjak.*

Përkundër presioneve e dhunës së llojllojshme të pushtetit izraelit që ka ushtruar e ushtron kundër popullatës palestineze, e në radhë të parë kundër intelektualëve dhe krijuesve letrarë, poezia e rezistencës vazhdon të krijohet e të pasurohet, e mbase në begatimin e saj ndikon vetë dhuna izraelite. Veçantia e kushteve në të cilat krijohet kjo poezi ndikon edhe në veçantinë e saj estetike, e drejtpërdrejt ndikon edhe në rolin e saj specifik ndaj letërsisë arabe në tërësi. Andaj poezinë e rezistencës duhet konsideruar si rezistencë të dyfishtë: në një anë si rezistencë përpjekjeve izraelite për ta mohuar identitetin kulturor të palestinezëve, e në anën tjetër si rezistencë rrymave tradicionale në letërsinë arabe.

Pikërisht për shkak të largimit nga tradicionalizmi poetët palestinez ishin të kritikuar nga predikuesit e tradicionalizmit, por në anën tjetër të përkrahur e të pëlqyer nga masat e gjera të lexuesve e nga modernistët të cilët duan që krahas stilit me fjalë të zgjedhura dhe rimës së rreptë poezia të ketë edhe përmbajtje të përcaktuar në temë, pra ku i kushtohet kujdes vlerave përmbajtësore.

Duhet thënë se poetët palestinez nuk janë të parët në letërsinë arabe të cilët kështu i trajtojnë marrëdhëniet e

përmbajtjes dhe formës në poezi, por ata bashkë me disa poetë të tjerë arabë, me produktion të pasur poetik ua kanë ngarrkuar letërsisë arabe këtë problem si problem të pakalueshëm teorik. Pikërisht duke iu falënderuar poetëve të tillë, teorikët dhe kritikët arabë të letërsisë sistematikisht e peshojnë problemin e sinqeritetit si kategori të rëndësishme poetike.

Poezia e rezistencës është poezi e angazhuar por jo poezi e politizuar. Kjo poezi paraqet një përvojë të përbashkët. Është interesante, ndoshta edhe e befafueshme, që kjo poezi nuk është e stërngarkuar me shprehje parollash të realitetit të revolucionit, dhe se si nocion i përgjithshëm revolucionit në të shumë pak është i pranishëm. Një gjë e tillë më tepër është e pranishme te poetët që krijojnë nëpër metropolet arabe, por larg teritoreve arabe të okupuara. Përkundrazi pra, poezia e rezistencës është shprehje e hollësishme e shkatërrimit të një populli. Realiteti palestinez në të popthuj shprehet intimisht nëpërmjet të përjetimeve të thella individuale - autentike. Tekefundit shumica e poetëve që krijojnë poezi të këtillë i ndejnë dhe përjetojnë këto përjetime të popullit. Andaj sinqeriteti në mënyrë të denjë është i përfaqësuar në poezinë e rezistencës por, të theksojmë se jo në kuptim të realitetit biografik, sepse të shprehurit e realitetit individual në të vërtetë është në funksion të shprehjes së realitetit kolektiv ose të përvojës për të. Posa të lexohen poezitë e tilla të këtyre poetëve mund të përfundohet se ajo poezi është epike madhështore kuptimet dhe porositë e së cilës janë të orientuara në një drejtim të përgjithshëm.

Pra kjo poezi e ka luajtur dhe ende e luan rolin kryesor në rezistencë dhe e ka ruajtur frymën e patriotizmit dhe frymëzon për ndjenja më të thella njerëzore. Kjo është pra poezi popullore, sepse bart problemin e popullit dhe i shpreh

vuajtjet, mundimet dhe dëshirat e tyre. Poetët palestinez janë me popullin dhe poezia e tyre është këngë e jetës dhe e shpresës dhe në një situatë të tillë në të cilën gjenden palestinezët, poeti palestinez duhet të krijojë në kontekst të kërkesave të revolucionit.

Poezia palestineze përshkohet nga spektri emocional ku me shprehje poetike përshkruahen vuajtjet individuale, kujtimet e hidhura, por kjo nuk do të thotë se kjo është poezi e dëshprimit, e pikëllimit, por kujtimi i represalieve i përshkruar nëpërmjet të dramave personale, narracioni poetik për shlyerjen e gjurmëve të familjeve, vendbanimeve etj. për lexuesin janë faktorë për njohjen e realitetit të përbashkët. Vuajtja për shembull në poezinë palestineze është emocion i përbashkët e cila në komunikim me lexuesin shndërrohet në revoltë. Ose vendet e masakrimeve të ndryshme poeti artistikisht nuk i len të harrohen dhe i përdor si motive të rezistencës, etj. Me fjalë të tjera vuajtjet e masakrimet të shprehura në poezinë e rezistencës gjithnjë janë nxitje për luftë të përgjithshme për një ardhmëri më të mirë, të lumtur, të shndritshme ku plagët e përgjakshme do të zëvendësoheshin me lule, e dhuna me liri, dashuri, dinjitet njerëzor etj. Pra për shkak se e përshkruajnë vetë jetën reale të popullit të gjithë poetët palestinezë që shkruajnë poezi të rezistencës janë poetë lirikë. Ndonjë prej tyre ka filluar ndoshta si romantik, por shpejt është ndeshur me të vërtetën e hidhur të të jetuarit, e siç dihet jeta e palestinezëve nën shtetin izraelit është e mjerueshme, përplot rreziqe, jetohet prej mëngjesit deri në mbrëmje, kurse kush e din se ç'bëhet nesër. Në këto poezi pra gjen shprehje thirrja për gjithë popullin palestinez, kudo që të jetë, në Palestinë e gjetiu, që të këmbëngulin në idealin e vetëm të tyre, pra atë të lirisë kombëtare

Megjithatë siç e thamë edhe më parë, përkundër të gjitha këtyre përjetimeve, këta poetë në asnjë moment nuk i lëshon besimi për njeriun dhe për të nesërmen e tyre. Prandaj sado të ketë diç pesimiste, diç individuale në vjershat e tyre, në to gjithmonë është e pranishme shpresa për të mirë dhe shoqërorja.. Dhe kjo i bënë poetët palestinezë, poet dhe njerëz, luftëtar e mendimtar. Pra poeti kurr nuk e ka humbur besimin dhe vazhdimisht ka mbjellur optimizëm duke këmbëngulur në rezistencë. Pra poezia e tij është plot besim, bindje, ambicie për një shoqëri të re njerëzore të lirë e përparimtare. Andaj M. Dervishi shkruan:

*Vij nga vdekjet duke kënduar këngë*

*vij për të jetuar.*

*Thika e xhelatit më ka mësuar mua*

*Të eci mbi plagën time.*

*Të eci, dhe të eci pa u lodhur.*

*Më ka mësuar të rezistoj.*

*Të rezistoj.*

Opusi i gjerë poetik i Mahmud Dervishit në mënyrë më të denjë e prezenton poezinë palestineze të rezistencës si të tillë çfarë e prezentuam dhe njëherit ai është njëri ndër themeluesit e saj. Pa dyshim Mahmud Dervishi në mos qoftë poeti më i njohur i poezisë arabe-palstineze, gjithsesi është ndër më të njohurit, i popullarizuar në tërë botën arabe dhe i përkthyer në afro katërdhjetë gjuhë botërore ku njëherit poezia e tij jep kontributin e saj edhe në afirmimin e revolucionit palestinez duke e përshkruar mjaft bukur rezistencën palestineze kundër pushtuesit izraelit. E tërë ajo që u tha për "sinqeritetin" e poezisë palestineze në tërësi, për aspektet e saj poetike, për

angazhimin e saj në radhë të parë ka të bëj me poezinë e Mahmud Dervishit, këtij poeti që siç dihet palestinezët e quanin "*poet me valixhe në dorë*", poezia e të cilit merr pjesë në përcaktimin e kahjeve të krijimtarisë poetike arabe. Madje mund të thuhet se ky poet nuk është kurrfar teoricienti, por krijues poezia e të cilit ndikon dukshëm në traditën letrare arabe.

Mahmud Dervishi është adhurues i stilit të lirë i cili qysh kur filloi të shkruaj poezi startoi me stil të lirë që njehërit do të thotë edhe ndërprerje e tradicionalizmit poetik. Dhe pikërisht kjo e bënë të rëndësishëm Mahmud Dervishin, pra këte duhet shikuar në kontekst të traditës letrare arabe. Siç kanë patur rast të lexojnë edhe lexuesit tanë, në traditën poetike arabe e cila ishte mjaft e afirmuar e që zgjati pothuaj deri në kohën kur Mahmud Dervishi filloi të shkruaj poezi, dominonte poezia të cilën e përbënin kasidet (vjershat) monorimike dhe tematikisht të larmishme. Rregull i vetëm poetik ishte që kasidja të shkruhej në metrin e vet karakteristik në monorimë me fjalë të zgjedhura e të përshtatura dhe në aspektin tematik të jetë krejtësisht e lirë, kështu që në kaside poetit i lejohej të bredhë nëpër shumë tema të paharmonizuara në mes veti. Përkundër kësaj poezie Mahmud Dervishi fillon të shkruaj vjersha tematikisht të përcaktuara në një temë dhe të parimuar, pra shkruante vargje të lira të pakushtëzuara të përfundojnë në të njëjtën rimë. Prandaj ai ishte ihtar i lirisë sa i përket formës dhe traditës së vjetër poetike.

Natyrisht se do të ishte gabim po të mendohej se Mahmud Dervishi ishte i pari i cili në letërsinë arabe poezinë e shkruan në stil të lirë. Ç'është e vërteta ky nuk ishte as i pari as i vetmi, sepse stili i lirë kishte filluar të kultivohej edhe para tij por, gjithsesi ishte ndër më të guximshmit që në atë kohë shkruajnë,

me fjalë të tjera promovojnë stilin e lirë në poezinë arabe që njëherit në atë kohë edhe bëhet kalimi zyrtar nga tradita e vjetër poetike, nga klisheu i kasides në poezinë e lirë. Siç e përmendëm, poezia tradicionale preferonte shumë estetikën, pra preferonte që poeti të kujdesej kryekëput për atë se si po e thotë, si t'i zgjedh fjalët e përshtatshme për rimë, e jo për atë se çka thuhet, pra jo për përmbajtjen. Kurse poetët si Mahmud Dervishi në aspektin e formës duan lirinë dhe mendojnë se letërsia duhet të merr pjesë në formimin e realitetit dhe kujdesen për funksionin shoqëror të letërsisë si art.

Poezia e Mahmud Dervishit është gjithnjë në funksion të atdhedashurisë dhe lirisë, prandaj edhe në këto poezi të ndjeshme ka përplot figura nëpërmjet të cilave përçohen mjaft mesazhe me porosi të qartë të mbajtjes gjallë të frymës së atdhedashurisë si dhe të rezistencës për liri e pavarësi kombëtare. Sjellja nëpërmjettë këtyre poezive e ngjarjeve të dhimbshme rifreskon kujtesën e palestinezëve dhe mban gjallë ndjenjën dhe dashurinë e tyre për atdheun e tyre të lire. Kështu M.Dervishi në poezinë e tij me titull “E pamundura” shkruan:

*Po vdes duke dëshiruar*

*Po vdes duke u djegur*

*I varur po vdes*

*I therur povdes*

*Por nuk them:*

*Kaloi dhe u zhduk dashuria jonë*

*Dashuria jonë nuk vdes.*

Andaj marrë në tërësi mund të themi se në poezinë e Mahmud Dervishit përfshihen të gjitha temat, natyrisht në radhë të parë lufta palestineze për pavarësi, rezistenca e këtij populli të

pafat. E këto nënkuptojnë para së gjithash, rezistencën ndaj dhunës, përpjekjes së shlyerjes së identitetit kombëtar e kulturor nga një anë, dhe në anën tjetër ruajtja e identitetit kombëtar, e autoktonisë shpirtërore, gjakimi i humanitetit në botën njerëzore.

Në fund t'i themi edhe disa fjalë: poezitë e Mahmud Dervishit të përfshira në këtë përmbledhje janë poezi të fazës së hershme të krijimtarisë së këtij poeti por edhe të asaj kur ky poet e arrin kulminacionin e famës së tij si poet të shkruara deri në fund të dekadës së nëntë të shekullit të kaluar, dhe se një numër të vogël sosh edhe më parë i kemi botuar nëpër gazetë dhe revistat tona herë pas here. Po ashtu, të themi se poezinë e Mahmud Dervishit e prezentuam pak a shumë vetëm në kontekstin e poezisë së rrezistencës kurse për vlerat konkrete artistike nuk folëm duke shpresuar se lexuesit duke i lexuar këto vjersha do të gjejnë kënaqësi dhe do t'i zbulojnë vlerat e tyre artistike.

*Dr. Abdullah Hamiti*



**MOMENTI LAMTUMIRËS**

Pimë çaj...  
Pimë duhan  
I shfletuam netët tona  
Dhomën, duart  
Dhe të kaluarën tonë.  
Flisnim, ah flisnim

Çka?!  
Shiu ra  
Në zemrat tona.  
Pimë duhan  
I këmbuem adresat e mërgimit tonë  
I këmbuem fotografitë  
Dhe shungurimet.

Vetëvrasjet i shtymë  
Vetëm për një çast... dhe u betuam  
Se me kohën do t'i harrojmë  
Dy plagët tona!

Pimë duhan  
U përqaftuam  
I shtrënguam duart  
Dimri hyri në shuplaka  
Ruga jonë u shndërrua në dy labirinte

Dhamë shenjë  
Me duar...  
Në sy diçka u fik  
Në zemra diçka u fik  
Në zemra diçka u ndërpre!

**KITARISTI ENDACAK**

Fotograf ishte  
Por fotografitë  
Rëndom nuk i hapin portat  
Nuk i thyejnë  
E as balena i ngjan hënës  
(Miku im, o kitarist  
Më merr mua...  
Deri te dritaret tua të largëta)

\* \* \*

Poet ishte  
Por vjersha  
Iu tret në kujtim  
Kur e pa Jafën  
Nga terraca e anijes  
(Miku im, o kitarist  
Më merr mua...  
Deri te sytë me mjaltë)

\* \* \*

Ushtar ishte  
Por arma  
Ia theu gjunin e majtë  
Dhe e shpërblyen  
Me gradë më të lartë  
Me këmbë të drunjtë

(Miku im, o kitarist  
Më merr mua...  
Në qytetin e fjetur)

\* \* \*

Kitaristi do të vijë  
Netëve të ardhshme  
Kur populli në ushtri shkon  
Kitaristi do të vijë  
Nga vendi i panjohur  
Kur populli të festoj lindjen e shehidëve  
Kitaristi do të vijë  
Lakuriq, apo i veshur shkel e shko  
Kitaristi do të vijë  
Gati po e shoh atë  
Në jele po i marrë erë gjakut të tij  
Gati po e shoh atë  
Duke ecur rrugëve  
Gati po e dëgjoj  
Duke bumbulluar si tufan  
Shikoni:  
Atë këmbë prej druri  
Dëgjoni:  
Atë muzikë prej mishit të njeriut

## PËR DËSHIRAT

Mos më thuaj:

Të isha bukëshitës në Algjer

T'i këndoj trazirave të kohës!

Mos më thuaj:

Të isha çoban në Jemen

T'i këndoj trazirave të kohës!

Mos më thuaj:

Të isha kamarier në Havanë

T'i këndoj ngadhnjimeve ndaj pikëllimeve të mia!

Mos më thuaj:

Të punoja në Asuan si hamall i vogël

T'i këndoj shkëmbinjëve

\* \* \*

Miku im,

Nuk do të derdhet Nili në Vollgë

As Kongo e Jordani në Eufrat

Çdo lum e ka burimin, shtratin dhe jetën e vet!

Miku im, toka jonë nuk është sterile

Çdo tokë i ka frutet e veta

Çdo mëngjes e ka përvjetorin e vet revolucionar!

**THA KËNGËTARI**

Kështu rritet druri  
Dhe gdhendet guri  
Ngadalë, ngadalë  
Në përroin e mëndafshtë!

Këngëtari në rrugë të qytetit  
Magjistari i melodisë  
I tha erës së trazuar:  
- Më shkatërro për tërë jetën  
Ashtu sikur më shkatërroi fati,  
Pi me mua për nder të triumfit të të ndjerit  
Kështu bie shiu  
Bisedë e mallkuar qytetare!

U larguan prej tij dëgjuesit  
Dhe të dehurit ...  
E lidhën  
Dhe në burg ushtarak e hudhën  
Ia shajtën nënën, babanë  
Kurse këngëtari...  
I këndon rrezeve të diellit vjeshtor  
Dhe plagën me litar e lidh!

Këngëtari në kryqëzim të dhembjes  
Plaga si yll i shkëlqen  
Njerëzve rreth tij u foli  
Për çdo gjë ... pa pendim

Vdiq duke qëndruar kështu  
Vdiq i drejtë si dru  
Kështu kryqëzimi bëhet  
Fener ose melodi  
Kështu bie shiu  
Kështu rritet druri...

**ZËRI DHE KAMXHIKU**

Po të kisha një kullë  
Në xhep do ta kisha burgosë vetëtimën  
Dhe retë i kisha mbuluar

Po të kisha vela në det  
Do t'i vëja në grusht velat dhe furtunat  
Dhe detin e hapur në gjum do t'e veja

Po të kisha shkallë  
Mbi diell do t'e vëja idenë time  
Që në tokën e shkretë po shkatërrohet...

Kalë po të kisha kalë  
Frerët do t'i leja  
Dhe në shkëmb erën do ta përforcoja...

Po të kisha arë dhe pllug  
Do t'i mbillsha zemrat dhe vargjet  
Në brendi të dheut ...

Po të kisha një ud \*  
Do të theja heshtjen me pyetje të komponuara  
Dhe shokët do t'i argëtoja ...

\*. Lloj instrumenti muzikor

Po të kisha këmbë  
Do të ecja, do të ecja deri në vdekje  
Prej mali në mal ...

Po të kisha ...  
Por as kryqëzimi nuk është i imi  
Unë i takoj atij  
Bile edhe shkatërrimit!

Çka mbetet o i denuar?  
Nata përsëri u ftoh  
Dhe klitha: nuk jam gati?!

Por një ditë zëri im u coptua  
Ende nuk jam gati!

Rrihni me kamxhik nëse mundeni  
Shkilni me këmbë kufomën  
Ende klith: Nuk jam gati!

**KËNGA E ROBIT**

Faculeta të shpërndara të dashurisë sime  
Ju përshëndes!  
Sepse thoni më tepër  
Sesa gugurima e pëllumbit  
Dhe më tepër se lotët  
Prapa teheve të shpatës së fjetur  
Në ëndërra të ikura!

Dritare të hapura të dashurisë sime  
Nëpër qytet po kalon  
Para jush dasmë madhështore  
Dhe vajtimi i nënës së pikëlluar  
Kurse prapa perdeve hënat tona  
Të kalbura si mbeturina  
Dhe qelija ime ... e mbyllur!

Gota të ndyta të fëmijërisë  
Dhe në kohë të pjekurisë  
Pimë, pimë të shfrenuar  
Me buzë të etura  
Dhe thamë:

Frikohemi për buzët tona  
I frikohemi vesës dhe ndryshkut  
Si koha jonë që kaloi në koprraci  
E mes meje dhe ty është lumi prej gjaku

Sytë e dashurisë të varur  
Në litarin e dritës  
Gërshetohen në dy mollëzat e krahërorit  
A nuk e dini se unë  
I vuaj dy robërime  
Dy plaga: për ty dhe për lirinë  
Dhe flini prapa brigjeve të panjohura  
Derisa kështu besnikërisht ju dua

**LINDJA**

- Drunjtë e fikut

Babai yt ...

Kasollat nga balta

Sytë e katundarëve

Qanin në tetor!

- I linduri është djal

I treti ...

Sisa është e shterrur

Dhe era

I vringëllon gjethet e fikut!

Fallxhorja e brengosur

Më tha

Duke përshpëritur:

Kjo degë është e pikëllueshme!

- Nënë

I kam mbushur të njëzetat

Lemi gajlet dhe flej

Nëse furtuna i then

Në tetor...

Që të tretë...

Atëhere rrënjët e fikut

Të forcuara në tokë ... dhe në baltë

Ta japin një degë tjetër ...

Edhe një degë!

**FOTOGRAFIA NË HORIZONT**

E pash ballin tënd veror  
Të ngritur në muzg  
E flokët të çohen si të dhisë  
Në horizont në barin e reve

Syri do të donte të fluturoj te ti  
Ashtu siç fluturon gjumi nga burgu im  
Zemra do të donte të afrohej te ti  
Në shkëmb të pikëllimit

Buzët do të donin të thithin  
Nga buzët tua ...  
Krypën e diellit dhe kohën

Do të doja, do të doja, por  
Prapa parmakëve të dritares sime  
Përshëndetem me fytyrën tënde që qan  
Duke u fundosur mbi gjakun e diellit  
Që kot derdhet në horizont  
Dhe pos plagës së zemrës i barti edhe dy plaga  
Megjithatë ...  
Do të doja t'i bashkoj ... e t'i vë nën jastëk  
Me dorën e cila lufton kundër pikëllimit!

**NDJESA**

Ëndërrova dasmën fëmijërore  
I ëndërrova dy sy të gjerë  
I ëndërrova ato gërsheta  
E ëndërrova ullirin që nuk shitet  
Me pak para të imëta  
E ëndërrova historinë tënde të murosur e të pamundur  
E ëndërrova kundërmimin e bajamës  
Që pikëllueshëm përhapet netëve të gjata  
E ëndërrova familjen time ...  
Dorën e motrës sime  
Se si ma jep kordonin e heroizmit  
E ëndërrova natën verore  
Shportën me fiq  
Ëndërrova shumë  
Andaj më ndjeni!!.

**PREMTIMET E FURTUNËS**

Nejse ...

Medoemos vdekjen duhet ta rrefuzoj  
Ta ndezi lotin e këngëve që po derdhet  
T'ia prej drurit të fikut të gjitha degët e thata  
Edhe nëse i këndoj gëzimit  
Prapa syve të frikësuar  
Këtë e bëj për shkak se furtuna  
Më premtoj verë dhe dolli të reja  
Dhe ylbera  
Dhe për shkak se furtuna  
E shlyu zërin e zogjëve të marrë  
Dhe degët jo të shëndosha  
Nga trupat e drunjve të drejtë.

Nejse ...

Medoemos duhet të mburrem me ty, plagë e qytetit  
Me ty fotografi e vetëtimës në netët tona të pikëlluara  
Rruga vëreret në fytyrën time  
Më ruaj nga errësira dhe nga shikimet e këqia  
Do t'i këndoj gëzimit  
Prapa syve të frikësuar  
Që kur fryu furtuna në atdheun tim  
Më premtoj verë dhe ylbera

**MOS MË BRAKTIS**

Balli yt është atdheu im - andaj më dëgjo  
Mos më braktis  
Prapa rrethojës  
Si barin e shkretëtirës  
Si pëllumbin e braktisur  
Mos më braktis  
Si hënën e ngratë  
Si yllin të varur mes degëve  
Mos më lë  
Të lirë në pikëllim  
Më burgos  
Me dorën që si dielli shëndrit  
Mbi dritaren e burgut  
Dhe mësou të më djegësh  
Nëse je e imja  
E dashuruar në drunjtë dhe gurët e mi  
Në dritaren time .. në atdheun tim  
Balli yt është atdheu im - andaj më dëgjo  
Mos më braktis!

**MOS FLEJ E DASHURA IME**

Kur bie hëna  
Si pasqyrat e thyera  
Mes nesh rritet hija  
Dhe legjendat vdesin  
Mos flej e dashura ime  
Plaga jonë bëhet dekoratë  
Bëhet lule në hënë ..!

Prapa dritareve tona është dita  
E dora e lumturisë më afrohet  
Më duket se bëhem flutur  
Në xixëllonjat e luleve të kaçës  
Bisedë në vesë  
Që më fliste në heshtje  
Mos flej e dashura ime  
Prapa dritareve tona është dita!

Nga duart më ra lulja  
Që nuk ka aromë  
Mos flej e dashura ime  
Zogjtë po vdesin  
Kurse qepallat janë si kallinjtë  
Që pijnë natën dhe fatin  
Zëri yt është i ëmbël si puthja  
Mëkati është dhunë  
Degët e ullirit qajnë

Në breg në një guri  
Duke i kërkuar rrënjët e tij  
Diellin dhe shiun  
Mos flej e dashura ime  
Zogjtë po vdesin

Kur bie hëna  
Si pasqyrat e thyera  
Nga larg humbet hija  
I shmangemi ikjes sonë  
Kur bie hëna  
Dashuria bëhet epike  
Mos flej e dashura ime

**SHI I IMËT I NJË VJESHTE TË LARGËT****I**

Shi i imët i një vjeshte të largët  
E zogjtë janë të kaltërt, të kaltërt  
Kurse toka e lumtur  
Mos thuaj se jam re shiu  
Sepse unë nuk dua gjë  
Nga vendlindja ime që ka ra nga dritarja e trenit  
Pos faculetën e nënës sime  
Dhe shkaqet e vdekjes së re.

**II**

Shi i imët i një vjeshte të largët  
E dritaret tua janë të bardha, të bardha  
Dhe dielli në të perënduar  
Unë jam portokall i vjedhur  
Për çka pra po ik prej trupit tim  
Sepse unë nuk dua gjë  
Nga vendlindja ime e thikave dhe bilbilave  
Pos faculetën e nënës sime  
Dhe shkaqet e vdekjes së re.

**III**

Shi i imët i një vjeshte të mërzitshme  
E takimet janë të gjelbërt, të gjelbërt  
Dielli është baltë  
Mos thuaj: të kemi pa në vdekjen e jaseminit

Oj shitëse e vdekjes dhe aspirinit  
Fytyra ime ishte mbrëmje  
E vdekja embrion.  
Kurse unë nuk dua gjë  
Nga vendlindja ime e cila e harroi të folurit  
E atyre që mungojnë  
Pos facultetën e nënës sime  
Dhe shkaqet evdekjes së re.

## IV

Shi i imët i një vjeshte të largët  
E zogjtë janë të kaltërt, të kaltërt  
Kurse toka e lumtur.  
Zogjtë fluturuan në kohën që nuk kthehet  
A don ta njohësh atdheun tim?  
Dhe atë që është mes nesh?  
- Atdheu im është në pranga  
- Puthja ime e dërguar me postë  
E unë nuk dua asgjë  
Nga atdheu im që më flijoi mua  
Pos facultetën e nënës sime  
Dhe shkaqet e vdekjes së re ...

## I HUAJI NË QYTETIN E LARGËT

Kur isha i vogël  
Dhe i bukur  
Lulen e kisha shtëpi  
Dhe burimet ishin deti im

Lulja u bë plagë  
E burimet janë të etura

- A ke ndryshuar shumë?  
- Nuk kam ndryshuar shumë  
Kur si era kthehemi  
Në shtëpinë tonë  
Më shiko në ballë  
Në vend të lules e sheh palmën  
E burimet janë djersë  
Do të më shohësh si kur isha  
I vogël  
Dhe i bukur ...

## HËNA E DIMRIT

Do t'e torturoj trupin tënd të dëshmorit  
Dhe e shkrij atë në krypë dhe shkrepse  
Pastaj atë e pij shpejt  
si çaj...  
si verën dehëse  
si vjershën  
Në tregun e dështuar të poezisë  
Dhe u them poetëve:  
O poetë të popullit tonë të zellshëm  
Unë jam vrasës i paqës në të cilën  
Ishit të robëruar!!

Do të thonë: ishte ... si lypës në mërgim  
e kthenin nga çdo dritare  
e ai kërkon mëshirë  
e jo dy të dashuruar  
që do ta përmendin  
e as ... as gjuhë!  
- Zemra ime është në hënë  
Në vend u gurëzua  
dhe thanë ... ishte!  
E unë jam në asfalt  
nën erë e shi  
me zemër të biruar  
Nuk hapen dyert në fytyrën time  
E as që zgjaten dy duar kah duart e mia

Sytë e mi janë drejtuar kah hëna e dimrit ...  
Dhe tashmë janë mbuluar nga gjaku im ...  
Zemra ime është si fletë duhani  
Mos më mundoni o ju qyqarë  
Nuk kam vrarë kend pos qyqarin e mjerë  
Qysh dje më premtoi  
E kur në mëngjes vajta tek ai .. tradhëtoi ...

**I FRIKUARI NGA HËNA**

Më fshihni, erdhi hëna  
Sikur të ishte pasqyra jonë gur!  
Sekreti im është sa një mijë sekrete  
E gjoksi yt është i njollosur  
Kurse sytë të drejtuar kah lisi  
Nuk i mbulojnë yjtë  
Përkatite krypën dhe peçen  
Më fshihni ... prej hënës!

Një person dje udhëtoi  
Edhe duart tona janë në udhëtim  
Shtëpia ime ishte një hendek  
E jo sallanxhaqe për hënë  
Më fshihni ... të vetmuar  
Dhe merrne namin dhe pagjumësinë  
Ma vendosni jastukun tim  
A je ti tek unë  
Apo hëna?!

**FTESË PËR KUJTIM**

Kaloi nëpër kujtimet e mia  
dhe nëpër tregjet e qytetit  
kaloi  
edhe nëpër dyert e restorantit dimëror  
kaloi  
edhe nëpër kahven e djeshme të nxehtë  
kaloi.  
Kujtimet e mija e brejnë atë  
Zogjtë e shpërngulur të pikëlluar  
Nuk harron asgjë pos fytyrës sate  
Si humbi?  
E ti je çelësi im deri te zemra e qytetit?

**POEMA VAJZAT E TROJËS**

Lamtumirë netë të panjollojura  
o mure të Trojës  
Kemi dal nga vendstrehimet tona  
në dasmat e sulmuesve tanë  
që të vallëzojmë mbi vdekjen e trojanëve

Ne jemi pengje të tyre, ua japim virgjinitetin tonë  
dhe çka të duan  
sepse ata janë më të fuqishëm  
dhe flejnë në shtretërit e vrasësve të trimave të Trojës

Lamtumirë netë e ëndërra të pastërta  
kujtime të miqëve tanë  
Nga sot, ne jemi pengjë  
nga gjurmët e Trojës

**PËRSËRI**

Përsëri  
Po flen vrasësi  
Nën lëkurën time  
E trekëmbshi po bëhet  
Tregues  
Apo zymbyl  
Në qiellin e malit që po digjet

Hija ia hjeki duart prej ballit tim  
Dhe u zhdukëm në mesditë

Përsëri  
Kalon ushtria  
Nën lëkurën time.  
Përsëri  
Këndon me buzët e mia  
Himnin e bukur kombëtar

Hija ia hjeki duart prej ballit tim  
Dhe u zhdukëm në mesditë

Përsëri  
Ikin martirët  
Prej këngëve të poetëve.  
Përsëri  
Zbritëm nga kryqëzimi ynë

Por tokën nuk e prekim  
Dhe qiellin nuk e shohim

Hija ia hjeki duart prej ballit tim  
Dhe u zhdukëm në mesditë

Përsëri  
U bashkuam  
Unë, vrasësi dhe vdekja armiqësore  
Liria m'u bë barrë  
Në zemër  
E sytë e saj internim dhe atdhe  
Përsëri  
Uji zhduket në retë  
E ne ftojmë për xhihad!.

Hija ia hjeki duart prej ballit tim  
Dhe u zhdukëm në mesditë

E vranë në mesditë  
Në vend timin,  
Dhe nuk më internuan  
Përsëri  
Sepse vrasësi është  
Nën lëkurën time ...

**QYTETI I OKUPUAR**

Vogëlushja të cilës iu dogj nëna  
Para syve të saj ...  
U dogj si mbrëmja.  
I thanë: vitin e ardhshëm  
Emri i saj do të bëhet  
Emër heroji  
Ti do të shkosh pas saj  
Nëse pajtohen profetët!  
Voglushja të cilës iu dogj nëna  
Para syve të saj ...  
U dogj si mbrëmja.  
Prej asaj dite  
Nuk e don hënën  
As gjakun  
Kurse sa herë që vie nata  
Ajo klith:  
Unë e kam vrarë hënën  
Sepse ajo më tha: ... tha ... tha ...  
Nëna yte nuk i ngjan portokallit  
E as trupit të drurit  
Nëna jote është në varr  
E jo në qiell

Voglushja të cilës nëna iu dogj  
Para syve të saj  
U dogj si mbrëmja

**KALIMTARI**

Atdheu im është larg  
E tërë pasuria e tij u shkri  
Në brendinë time ...  
Por nuk e shoh.  
Edhe ti je larg  
Por të shoh  
Si përpëlitje e papritur e burimit  
E në trup ndjej dëshirë për të këndua  
Për të gjithë portet  
... Unë të dua  
Por,  
Nuk i dua këngët e shpejta  
As puthjet e shkurtëra  
Kurse ti i don ato  
Si marinarët e dëshpëruar ...

Shikoj nëpërmjet zambakëve që shkunden  
Dhe nëpërmjet duarve tua të humbura  
Shikoj rrufenë si ma shlyen fytyrën e vjetër  
Në ballkonin që nuk ekziston  
E ti më dashuron  
Thua -  
Për shkak të kësaj mbrëmje.

Atëherë të vallëzojmë  
Unë, uji dhe hija

Sepse hija dhe uji nuk dijnë për tradhëti  
As për humbje  
Nuk mbajnë në mend  
As nuk harrojnë  
Por ... përse?  
Përse disku u ndal?  
Kush e ka grith diskun  
Përse sillet në vend:  
Atdheu im është larg  
Atdheu im  
Atdheu im  
Atdheu im

**HAPAT NË NATË**

Vazhdimisht  
Natën dëgjojmë hapat që afrohen  
Dhe dera e dhomës sonë thyhet  
Vazhdimisht  
Si retë kur shpërndahen!.

Hijen tënde kush ma dëboi  
Çdo natë nga shtrati im?  
Hapat po afrohen e sytë tu janë qytetet  
E duart tua janë bllokadë rreth trupit tim  
Hapat po afrohen  
Përse po ikën hija që po e imagjinoj  
Oj sheherzadë?  
Hapat po afrohen por nuk hyjnë  
Bëhu lis  
Që t'e shoh hijen tënde  
Bëhu hënë  
Që t'e shoh hijen tënde  
Bëhu thikë  
Që t'e shoh hijen tënde në hijen time  
Bëhu lule në hi

Vazhdimisht  
Natën dëgjoj hapa që afrohen  
Po bëhen internimi im  
Po bëhen burgjet e mi ..

Përpiqu të më vrasësh  
Me një goditje  
Mos më vrit  
Me hapat që afrohen!..

**MË DUKET SE TË DUA**

Përse e duam këtë udhëtim  
Kur deti më largon prej syve tu  
Dhe në ne ndizet rëra ...  
Përse e duam?  
Kur fjalët që nuk i folëm  
Na ndjekin  
E të gjitha shtetet janë pasqyra  
Dhe të gjitha pasqyrat janë stena  
Përse e duam këtë udhëtim?

Këtu ty të vranë  
Këtu mua më vranë  
Këtu ishte heroinë e lumit dhe epit  
Ndërsa lumi nuk e ndjen mundimin  
Nuk flet  
Nuk vuan

Më duket sikur u tretën të gjitha kodrat  
Sikur unë të dua  
Sikur aeroporti francez i stërmbushur  
Me mall e me njerëz  
I gjithë malli është legal  
Pos trupit tim  
Ah ... atdheu im

Afroju buzëve të mija  
Dhe largoju puthjes së paarritshme  
Më duket se të dua  
Shpërngulja më çiti në rrugët e trupit tënd  
Shpërngulja më bllokoi në koridoret e trupit tënd  
Heshtjen time ia lë buzëve tua  
Dhe zërin tim e lë në fjokë  
Më duket se të dua  
Shpërngulja më fshihte në ujdhesat e trupit tënd  
- E gjerë e ngushtë është kjo hapësirë -  
Shpërngulja më fshehte në tubën e zambakëve  
Ktheje derdhjen e kohës sime  
Që të dij ku do të shpërthej barrikada ime  
- Kaloi një ditë pa martirë -  
Për çdo ditë nga një kufomë kemi  
Ata çdo ditë kanë dekorata  
Këtu lumi u nda mes nesh  
Si rojtar  
I dy brigjeve  
Për ne të largët si të afërt  
Dhe të afërt si të largët  
E këtu medoemos rojtar të ket  
Ah, mes nesh medoemos të ket rojtar  
Uji që i ndan dy brigjet sikur është  
Gjaku i trupave tanë  
Sepse këtu ishim dy brigje  
Sepse këtu ishim dy trupa  
E të gjitha shtetet janë pasqyra  
Dhe të gjitha pasqyrat janë stena  
Përse e duam këtë udhëtim?

**POEMA PËR TOKËN****I**

Tokën e quaj zgjatje e jetës sime  
Dorën time e quaj platformë të plagëve  
Shkëmbët i quaj krahë  
Zogjtë i quaj bajame dhe fiq  
Brinjtë e mi i quaj trungje  
Nga fiku në gjoks e këpus një degë  
Dhe e gjuaj si gurin  
Që e shkatërroj tankun e pushtuesve

**II**

Vendi im është larg nga unë posi zemra ime  
Vendi im është afër meje si burgu im  
Përse të këndoj për çfarëdo vendi  
Kur ai është në fytyrën time  
Përse të këndoj  
Për fëmijën që fle në safran  
Kur thika është buzë ëndrrës  
E nëna ime m'i ofron  
Sisat e saja  
Dhe para meje vdes  
Me aromën e qelibarit

**III**

Më duket se i kthehem të kaluarës  
Më duket se eci kah ardhmëria

Mes vështirësive dhe kënaqësive  
Po e vendosi harmoninë time  
Unë jam bir i fjalëve të thjeshta  
Dhe martir i hartës gjeografike  
Dhe lule e kajsijës së butë  
O ju që arrini të pamundshmën  
Prej fillimit deri në mbarim  
Ma ktheni dorën time  
Ma ktheni identitetin

## IV

Unë jam vëzhgues i therrtores  
Dhe martir i hartës gjeografike  
Dhe bir i njerëzve të thjeshtë  
Në shkëmb i pash krahët  
Në vesë i pash armët  
Kur zemrën time ma mbyllën  
Dhe rreth meje ngritën barikada  
Dhe qarkullimin ma ndaluan  
Zemra ime u bë e nxehtë  
Brinjët e mi shkëmbë  
Karanfili mugulloi  
Karanfili mugulloi

## V

Mbrëmje e hershme në fshatin e harruar  
Dhe dy sy të fjetur -  
Dhe dy sy të fjetur  
Kthehem tridhjet vjet mbarapa

Dhe pesë lufta  
Dhe shoh se koha  
M'i merr zymbylat  
Këngëtari këndon  
Për zjarrin dhe të huajt  
Mbrëmja ishte mbrëmje  
Kurse këngëtari këndonte  
E pyetën atë:  
Përse këndon  
Ai u përgjigj:  
Për shkak se këndo  
Gjoksin ia kontrolluan  
Dhe vetëm zemrën e gjetën  
Edhe zemrën ia kontrolluan  
Dhe vetëm popullin e tij e gjetën  
Zërin ia kontrolluan  
Dhe vetëm pikëllimin e gjetën  
Pikëllimin ia kontrolluan  
Dhe vetëm qelinë e tij e gjetën  
Qelinë ia kontrolluan  
Dhe vetëm ata i gjetën në pranga

Prapa bregut  
Flen këngëtari i vetmuar  
E në muajin mars  
Nga ai u ngrit errësira

## I KTHYERI NË JAFË

Ai tashti po largohet prej neve  
 Dhe jeton në Jafë  
 Ia njeh asaj edhe gurtë  
 Dhe asgjë nuk i është e paqartë  
 Dhe këngët e pranuan atë ...  
 E pranoi takimi i tij i gjelbërt.  
 E ai tashti e zbulon fytyrën e vet -  
 E shpirtligi hyp në trekëmbësh  
 Ai tashti e tregon tregimin e vet -  
 E zjarret i vërshojnë zambakët.  
 Ai tashti po largohet prej neve  
 Që të jetoj në Jafë.

\* \* \*

Ne jemi larg tij,  
 Jafa është si valixhet e harruara në aeroport  
 Ne jemi larg tij,  
 Kemi fotografi në xhepat e grave,  
 Dhe në faqet e gazetave  
 Çdo ditë e shpallim tregimin tonë  
 Që t'i përvetësojmë vetitë e erës dhe puthjet e zjarrit.

Ne jemi larg tij,  
 Të plaçkitur me atë që ec deri në vdekjen e tij...  
 Për të shkruajmë një informatë të qartë  
 Dhe poezi moderne

Dhe shkojmë ... t'i hedhim pikëllimet në platotë e byfeve  
Dhe pohojmë: Nuk kemi shtëpi në qytet.  
Ne jemi larg tij,  
E përcjellim kufomën e të vrrarit,  
Vjedhim nga plaga e tij pambuk derisa të shkëlqejnë  
Dekoratat e durimit dhe pritjes

\* \* \*

Ai tash del prej neve  
Ashtu si del toka pas natës me shi  
Dhe rrjedh gjaku prej tij  
Dhe rrjedh ngyra prej neve.  
E ç'të themi për të? - humbin kujtimet  
Kurse nata është larg mbrojtësit të tij  
Ai tashti shkon tek ai  
Bomba ... apo portokaj  
Dhe nuk din të praj në krime  
Kur bëhet i pasur  
Dhe nuk din për drejtësi  
Dhe nuk beson në asgjë  
E as që gënjen  
Ai tashti po shkon shehid  
Dhe na i le neve refugjatët!  
Dhe fjeti  
E nuk kërkoi azil në porte  
E as nuk foli  
As nuk u arsimua  
Se nuk ishte refugjat.  
Toka është refugjate në plagën e tij  
Dhe u kthye me te.

Mos thuani: babatë tonë të cilët me vite ...  
Thuani: Vëllezërit tonë e morrënë tokën nga ne  
Ai tashti po humb  
Tash banon në Jafë  
Dhe ja njeh asaj edhe gurët  
Dhe asgjë nuk i është e paqartë  
Dhe këngët  
I pranoj ato.  
E pranoj takimin e tij të gjelbërt

Le t'i ngrisin duart tash refugjatët  
Në ajr, në ajr.  
Le t'i përhapin tash emrat e tyre  
Të lënduar, të lënduar.  
Le të shpërthejnë tash trupat e tyre  
Në mëngjes, në mëngjes.  
Le ta zbuloj toka adresën e vet  
Dhe ta zbulojë tokën tonë.

**FYELLI**

Mos më vritni o rojtarë  
mos më urreni  
frikohuni nga Zoti  
endacakët kërkojnë të flejnë  
në meloditë tuaja  
derisa të kalojnë në paqë

Ndryshk hekuri! Vrasës imi ndryshk hekuri  
mos prit  
Unë e kam dëgjuar fyellin  
mos prit  
Unë e kam braktisur shtëpinë

## E DIELA E KALTËRT

Në këngën time rrin një grua  
Thurr lesh  
Shërben çaj  
Kurse dritarja është e hapur për ditët  
E deti është larg

Të dielën vishet në të kaltër  
Argëtohet me revista dhe me adetet e popujve  
Lexon poezi romantike  
Shtrihet në kanape  
Kurse dritarja është e hapur për ditët  
E deti është larg

E dëgjon zërin e atij që nuk e pret  
E çel derën  
I sheh hapat e njeriut që udhëton  
E mbyll derën  
E sheh fotografinë e tij dhe pyet: A të mbytem?  
E zgjedh Mocartin  
Pushon me tokën ngjyrë qielli  
Kurse dritarja është e hapur për ditët  
E deti është larg

... Dhe u takuam  
Dhe e vendova detin në një pjatë dheu  
E u zhdukën këngët e mia

Ti, e jo kënga ime  
Dhe zemra është e çelur për ditët  
E deti është i lumtur ...

## PËR MBRËMJEN E FUNDIT

E tërë frika e tokës mblidhet në trup  
Dhe bëhet një fjalë  
Dhe bëhet një dëshirë e flaktë  
Bie hija prej saj  
Nuk është askush  
Nuk është askush ...

Dhe këndon e vetmuar  
Në rrugën e qerreve të humbura  
Për te çdo gjë  
Emërohet me zymbyla  
Dhe këndon e vetmuar

Shumë liqej ka  
E ajo është lum i vetmuar.  
Tregimi im është i shkurtë  
E ajo është lumi i vetëm.

Dimrit do t'e shoh  
Kur të më vras  
Do të qaj  
Do të qesh  
Kur të më vras  
Dimrit do t'e shoh.

Më kujtohet  
Apo nuk më kujtohet  
Jeta po kalon  
Nëpër stacione të trenave  
Dhe në rrugën e saj.  
Ishte diçka që i ngjante dashurisë  
Ajri coptohej  
Mes dy fytyrave të panjohura,  
Dhe dallga u gurëzua  
Mes gjoksave të afruar,  
Nuk më kujtohet ajo ...  
E ajo këndon e vetmuar  
Sonte për mbërmjen e fundit  
E thërras lulen e saj  
Kurse ajo këndon e vetmuar.

Fjalët e mia janë vetëm fjalë  
Kurse dritaret kanë qiellin  
E zogjtë hapësirën  
Hapat rrugën e lumenjtë grykën  
E unë kam kujtimet.  
Fjalët e mia janë vetëm fjalë  
E ajo është e para. Unë jam i pari  
Ishim. Nuk ishim  
Erdhi dimri  
Pa më vrarë...  
Pa qarë e pa qeshë  
Fjalë  
Fjalë.

**ASHTU THA DRURI I HARRUAR**

Jasht kohës  
Apo brënda malit të gjerë  
Është atdheu im.  
A e ndjejnë zogjtë  
Se unë jam atdheu...  
apo ... udhëtimi i tyre?

Unë pres...

Në vjeshtën e degëve të shkurtëra  
Apo në pranverën e rrënjëve të gjata  
Është koha ime.  
A e ndjen gazela  
Se unë jam trupi ...  
apo fryti i saj?

Unë pres ...

Në mbrëmjen që kalon para syve  
E kaltërt, e gjelbërt apo e artë  
Është trupi im  
A ndjejnë të dashuruarit se unë për ata jam  
Ballkon ... apo hënë?

Unë pres ...

Në thatësinë që e then erën  
A e dijnë fukaratë  
Se unë jam  
Burim i erës? A ndjejnë se unë për ata jam  
Thikë ... apo shi?

Unë pres ...

Jashtë kohës  
Ose brënda malit të gjerë  
Më harroi ai që e dua  
Por unë  
Nuk do të ndahem nga degët e humbura  
Në grumbullin e drunjëve

Unë pres ...

## KUNDËRSHTIMI

M'i shtrënguan prangat  
dhe m'i ndaluan fletoret  
dhe cigaret  
më vuan dhé në gojë  
e poezia është gjak i nxehtë  
kripë buke  
uj i syve  
shkruhet me thonj  
edhe me gurë  
edhe me thika

Do ta them këtë  
në burg ushtarak  
në banjë ..  
në shtallë ..  
nën kërbaç ..  
nën pranga ..  
me litare në qafë:  
milion zogj  
në degët e zemrës sime  
e përhapin melodinë e vrasjes

**TRENI I ORËS NJË**

Burri dhe gruaja ndahen  
E shlyejnë lulen nga zemrat e tyre  
E thejnë  
Del hija nga hija  
Bëhen tre:  
Burri  
Gruaja  
Dhe koha ...

Treni nuk vie  
Kthehen në byfe  
Flasin fjalë tjera  
Pajtohen  
Dhe duan të ikin në agim prej telave të kitarës  
Nuk ndahen ...

... dhe i bashkova dy anët në hapësirën e kësaj zemre  
Më ftuan shokët dhe rrugët të harroj dhe të strehohem  
në Madrid  
Që t'e harroj fytyrën e gruas dhe gëzimin tim  
Të harroj, të harroj, të harroj shumë

Po të vonoheshim pak  
Për trenin e vetëm  
Po të rrinim vetëm një orë në restorantin kinez

Po të kalonin shpezët duke u kthyer  
Po t'i lexonim gazetatat natën  
Po të ishim  
Burri dhe gruaja që takohen ...

**POZITA E VETME E SHUMË MARINARËVE**

Edhe më parë jemi takuar në këtë vend

Gjuanim gurë në uj

Kaloi peshku i kaltërt

U kthyen dy dallga

Dhe u lëkundëm

Duart notojnë kah aroma vjeshtore

Do të ecni një çikë

Dhe do t'i hedhni duart kah beronja

Tash: Ti nuk i përngjan dallgës

E as jeta ime

U drejtova përpjetë kah retë

Ma fëlliqi gjoksin peshku i kaltërt

Më magjepsi poezia e vdekja më thërret

Të vdes tashti mes ujit dhe zjarrit

E ajo nuk më shihte pasiqë flente

Do t'e derdhi djersën për popullin

Nuk do ta harroj këmishën në anije

Nuk do ta harroj vdekjen

Do të të lë përshtypje të ndijshme

Nuk the asgjë

Do të më gjuajsh tek peshqit dhe në therra

Sytë e saj flejnë, flejnë ...

E tejkaluam këtë ëndërr tonën

Do të shkojmë drejt rërës ku kanë humbur dy peshkatarë

Oj zonja ime!  
A mundemi tash trupat tonë t'ia gjuajmë macave  
Oj zonja ime! Ne jemi miqë  
Dhe peshku i kaltërt fjeti në dallgë  
Dhe ia dhamë këndët  
Që e gëzojnë atë  
Dhe shkëlqej nata  
Unë prej së afërmi e pashë këtë gëzim  
Dhe nuk dua kthim  
Nuk dua të kthehem  
Nga zemra jote i kërkoj vetëm rrahjet

Si të mbetet ëndrra ëndërr  
Si  
Të mbetet  
Ëndrra  
Ëndërr  
Në të kaluarën më dëbuan shikimet  
Dhe jemi takuar edhe më parë në këtë vend!

**HINGËLLIMA E FUNDIT**

E derdhi këngën  
Ashtu siç shkatërrohet lumi në ecajaket e veta  
Të gjitha këto janë koshalet e mia  
Ky është shkatërrimi im  
E dëshira flen

Në rrugët e mjerimit  
Arena e zbrazët  
Shqiponja e sëmurë  
Lulja e djegur  
E ëndrrat e mia ishin të thjeshta  
Dhe si të varura:  
Nëse këndoj

Ku je ti tashti?  
Nga cila kodër  
E merr hënën e artë  
Nga cila pritje  
E dashura ime distanca u shtua  
Nga fillimi i kodrës  
Dhe nga dëshira për vetëvrasje  
I dijmë mjetet

Po e shpejtoj vdekjen në zemrën time  
Në zemër  
Do të jesh udhëtim

Do të jesh ajër  
Ku je tash ti  
Në cilin aeroport  
Do ta duash qiellin?  
Unë po shkoj drejt arenës së panjohur

Të gjitha këto janë kosharet e mia  
Luftat e mia  
Rrugët e mia  
Kjo është dëshira ime e madhe  
Gjithmonë këndoj  
Të vetmën këngë  
Por  
Nuk do të kndoj më

## NJERIUT

Gojën ja mbyllën me pranga  
Duart ja lidhën me shkëmbin e vdekjes  
Dhe i thanë: Ti je katil!

\* \* \*

Ja morrën ushqimin, veshmabthjen, flamurin  
Dhe e gjuajtën në qelinë e vdekjes  
Dhe i thanë: Ti je hajn!

\* \* \*

E përzunë prej të gjitha porteve  
Ia morrën të dashurën e tij të vogël  
Pastaj i thanë: Ti je refugjat!

\* \* \*

Nuk lëvizin sytë dhe supet e mia  
E nata kalon  
Nuk ka dhomë për burgim të përhershëm  
As hallka për zinxhirët!  
Neroni vdiq por nuk vdiq Roma ...  
Para syve të saj e vranë!  
Edhe farat e zymbylit vdesin  
Dhe do të mbushet lugina me zymbyla ...!

**DHE U KTHYE NË QEFIN**

I

Tregojnë në anët tona  
Tregojnë me pikëllim  
Për shokun që shkoi dhe  
u kthye në qefin

\* \* \*

Ai quhej ...  
Nuk u kujtohet emri i tij!  
E nxorrën nga zemrat tona  
Nuk kërkuan asnjë fjalë  
E shtrinë në ajr si hi ...  
E lanë të vetmuar me plagën të cilën nuk din ta lidh  
S'e din atë procedurë ...  
Frigohem të dashur ... frigohem o jetima  
Frigohem se harroj atë në tollovinë e emrave  
Frigohem se do të shkrihet në uraganet e dimrit  
Frigohem se do të flejë në zemrat tona  
Plagët tona ...  
Frigohem se do të flenë!!

II

Jeta ... jeta në dhjamë nuk e kujton shiun  
Nuk qan në ballkonin e hënës  
Nuk i kalon orët pa gjum

Nuk i mbështet duart në mur  
Dhe nuk udhëton pas penit të pasionit  
Dhe nuk e pranon vetminë  
Nuk din për ledhatim  
Pos këngëve të këngëtarit shpresëhumbur  
Nuk thotë këndshëm: Allah!  
Vetëm dy herë!  
Dhe e humbi rrugën e vet  
Dhe nuk mendon shumë për pasionet..!

## III

Tregojnë në anët tona  
Tregojnë me pikëllim  
Për shokun që shkoi  
Dhe u kthye në qefin  
Kur prapa derës u dëgjuan hapat  
Nuk i tha nënës: Lamtumirë!  
Nuk u tha miqëve as shokëve:  
Takohe mi nesër!  
Nuk la as letër ashtu siç veprojnë ata që shkojnë  
Tha: Unë kthehem dhe i shlyej dyshimet  
Dhe nuk foli asnjë fjalë tjetër  
Nata e ndriçon nënën e tij e cila  
Bisedon me qiellin dhe me gjërat  
Thotë: o jastëk i shtratit!  
Oj valixhe e teshave!  
Oj natë! O yjë! O re!  
A mos e keni pa një endacak, sytë i ka si dy yjë?  
Duart e tij dridhen si përtëka  
Gjoksi i tij është jastëk i barinjëve dhe hënës

E flokët e tij janë kolovajzë e erërave dhe lules  
 A mos e keni parë një endacak  
 Duke udhëtuar por që nuk e zbukuron udhëtimin  
 Shkoj pa marrë gjë me vete kush i jep me ngrënë  
 Nëse ngel në rrugë  
 Kush ka mëshirë ndaj të panjohurit?  
 Zemra ime mendon te ti o djalosh ...  
 I thuani asaj: Nuk do të marrish përgjigjen  
 Plaga është mbi lotin ... mbi pikëllimin dhe mundimin!  
 Nuk do të bartish ... nuk do të durosh shumë!  
 Sepse ai ...  
 Sepse ai vdiq dhe nuk ishte i vogël!

## IV

Oj nënë!  
 Mos i nxirr lotët me rrënjë  
 Le të mbeten rrënjët oj nëna ime  
 Çdo dit natën flet:  
 Thot: O karavan i natës  
 Prej nga po vini?  
 U stërmbushën rrugët e vdekjes kur e vërshuan  
 të shpërngulurit  
 U mbyllën rrugët e pikëllimit ...po të pauzojshe dy herë  
 dy herë!  
 Po t'e pastrojshe fytyrën dhe sytë  
 Dhe nga gjaku jonë t'i bartish kujtimet  
 E atyre që dolën nga zemrat tona ... të dashurve tonë  
 që u shpërngulën  
 Oj nënë!  
 Mos i nxirr lotët me rrënjë

Leri dy pika loti në zemër!  
Se ndoshta nesër vdes babai i tij ... apo vëllai i tij  
apo unë shoku i tij!  
Leri për ne ...  
Për ata që vdesin nesër dy pika ... dy pika

## V

Tregojnë në anët tona për shumë shokë  
Fytyrat e të cilëve i djegën plumbat  
Dhe gjoksat e tyre ...

Mos i komentoni gjërat!  
Unë e pash plagën e tij  
Nga larg, gjatë e vështrova atë  
Zemra ime është kthyer kah fëmijët tanë  
Dhe çdo nënë e përqafton djepin  
O ju miq që jeni shpërngulur larg  
Mos pyetni: Kur kthehet  
Mos pyetni shumë

**TRI FOTOGRAFI****I**

Hëna ishte  
E ftohtë si e kishte shprehi -që kur lindëm ne -  
Pikëllim në ballin e tij të përlotur  
Si përrockat ... përrockat  
Afër mureve të fshatit  
Mbet i pikëlluar  
Duke bredhur ...

**II**

I dashuri im ishte  
I mrrolur si e kishte shprehi -që kur u takuam-  
Retë u vrërën në sytë e tij  
Mbjellin vrërësira në horizont  
E zjarri është pranë tij  
Dhe mua m'i tregon epopetë  
Dhe ende natën lexon poezi ëndërrore  
Më pyet mua për dhuratën  
E çadra prej qimeve është e butë

**III**

Babai im ishte  
Si e kishte shprehi, i shtrirë, i lodhur  
Kudo që të shkojë vërsulet pas pogaçes  
Për shkak të saj ... i mbyt dhelprat  
Dhe krijon fëmijë ...

Dhe pluhur ...

Dhe yjtë ...

E vëllai im i vogël i ka grisur teshat

Dhe është i molisur

E motra ime e madhe ka blerë çorapa!

Dhe çdonjëri nga ne prinë me kërkesa

E babai im - sipas shprehisë së tij -

Kthehet rrugës malore

I shkurton mustaqet!

Bën fëmijë ...

Dhe pluhur ...

Dhe yje ...

## SHPRESA

Ende në pjatat tua ka mbetur mjalt  
Largoni insektet nga pjatat tua  
Që të ruhet mjalta

\* \* \*

Ende ka kalavesha rrushi në hardhitë tuaja  
Largoni çakajtë  
O rojtar të hardhive  
Që të piqet rrushi ...

\* \* \*

Ende në shtëpitë tuaja ka hasra ... dhe derë  
Mbyllnja rrugën erës që e shpie kah fëmijët tuaj  
Që ata të flejnë të qetë  
Era është shumë e ftohtë ... le t'i mbyllin dyert ...

\* \* \*

Ende ka gjak në zemrat tuaja  
Mos e derdhni atë o baballarë ...  
Sepse në rrafshet tuaja ka kopshtarë ...

\* \* \*

Në vatrën tuaj ende ka dru për t'u djegur  
Dhe kafe ... dhe një grumbull hi

**TAKIMI I PARË**

U shtrëngua për duart e mia  
M'i pëshpëriti dy fjalë:  
"Do të takohemi nesër"  
Dhe e mbështolli atë rruga

\* \* \*

Dy herë e hoqa mjekrrën  
Dy herë këpucët i lustrova  
I mora teshat e shokut tim ... dhe dy lira ...  
Që asaj t'i blej sheqerkë dhe kafe me qumësht ...

\* \* \*

Rrij vetëm në bankë  
Të dashuruarit qeshin ...  
E balta ime u thotë:  
Edhe ne do të qeshim!

\* \* \*

Ndoshta ajo është duke ardhur rrugës  
Ndoshta ajo është e pakujdesshme  
Ndoshta ajo ... ndoshta ajo ...  
Kanë mbetur edhe dy dakika!

\* \* \*

Ora është katër e gjysmë  
Kaloi gjysmë ore

Një orë ... dy orë  
U zgjatën errësitat  
Nuk erdhi ajo që premtoi  
Për në katër e gjysmë

**KËNGA**

Në kohën kur kthehem në shtëpi  
I vetmuar, i papunë  
Pa gjëra të nevojshme për jetë e zemra ime pa lule  
Sepse qysh në mëngjes lulet e mia  
Ia kam shpërnda trimave ... lulet e mia  
Luftova kundër ujçëve ... dhe u ktheva në shtëpi  
Pa u qesh në zë ... në shtëpinë e dashur  
Pa buçitjen e puthjes së saj  
Pa prekjen e saj të butë  
Pa pyetjet e saj për mua dhe për lajmet e zënkave të mia  
I vetmuar bëj kafe  
I vetmuar pij kafe  
Dhe e shkatërroj veten ... dhe luftën time  
dhe e shkatërroj aromën time  
Shokë, ja këtu është feneri dhe poezitë  
Dhe disa cigare dhe gazetat si koncept  
Dhe kur kthehem në shtëpi  
E ndjej tëhuajsimin e saj  
Dhe i shkatërroj të gjitha lulet e jetës sime  
Fshehtësitë e burimit ... dhe dritën  
Që buron thellë nga zënkat e mia  
Dhe i akumuluj mundimet sepse jam i vetmuar  
Pa butësinë e supeve tua  
Pa përroin e syve tu

**PËR REZISTENCËN**

## I

Po t'i kujtonin ullinj të rrënjët e veta  
Vaji do të bëhej lot!  
Mençuri e gjyshërve  
Po të ta ipnim këmishën nga trupi jonë  
Era do të ishte e këndshme  
Por, era robit nuk i jep fëmijë  
Ne do ta nxjerrim me qepalla  
Gjemba dhe pikëllimet ... të nxjerrura  
E nëna i bart turpet tona dhe kryqin tonë  
Gjithësia intrigon  
Nën hijen e ullinjëve do të mbetemi  
Rreth tokës si këmishë!!

## II

Po ta donim më shumë grurin  
Do të ishim aromë e trëndafilut  
Por kallinjtë e tij janë më të pastër  
Andaj ruani kallinjtë tuaj nga uragani  
Me gjoks të lidhur në pranga  
Hapni ato barriera nga gjokset  
Nga gjokset që po thehen??  
Lidhi për qafe kallinjtë  
Ashtu siç e përqafove thikën  
Tokën, bujkun, rezistencën  
Më thuaj: Si shkatërrohen ...  
Këto tre të përdhosur  
Si të munden?

**LIDHSHMËRIA**

Nuk do të ndahemi  
Para nesh janë detërat e prapa mali  
E si të ndahemi?  
O miku im! O ti me sy të zi  
Më merr, si të ndahemi?  
Kur nuk më ka mbet askush pos teje!

\* \* \*

Ndoshta u mërzita nga fjalët tua  
O i etur prore!  
Ndoshta frikohem nga duart tua  
O i pamëshirshëm prore!  
Por unë nuk kam askend  
Askend!  
E si të ndahemi?

\* \* \*

O më i bukuri i egërsirave! O miku im  
S'ka gjë mes nesh pos hipokrizisë  
Dhe frikës nga lodhjet e rrugës  
Para nesh është deti  
Kurse prapa mali  
E si të ndahemi?

**PËR POEZINË****I**

Dje, i kënduam yllit në re  
Dhe u ngopëm duke qarë!  
Dje i qortuam shtetet, hënën,  
netët ... dhe fatin  
Dhe i dashuruam gratë!  
Ora trokiti e Hajami dehet  
E në realizmin e poezive të tij ka erotikë  
E ne mbetëm të guximshëm!

O miqtë e mi poetë,  
Ne jemi në një botë të re  
Ç'ishte ishte, e kush shkruan tash poezi  
Në kohën e erës dhe të atomit  
Krijohen profetë!

**II**

Vjershat tona janë pa ngjyrë  
Pa shije ... pa zë!  
Nëse nuk e bart fenerin prej një shtëpie në shtëpi  
Nëse nuk e kuptojnë të thjeshtit domethënien e tyre  
Së pari t'i përhapim ato  
Po amshohemi ... për heshtje!!

**III**

Po të ishin këto poezi  
Çekan në grushtin e proletarit

Bombë në supet e luftëtarit  
Po të ishin këto poezi!

\* \* \*

Po të ishin këto fjalë  
Pllug në duart e bujkut  
dhe këmishë ... derë ... apo çelës  
Po të ishin këto fjalë!

\* \* \*

Një poet thoshte:  
Sikur vjershat e mia t'i gëzonin miqtë e mi  
e t'i hidhëronin armiqtë e mi  
Prapë unë jam poet ....  
Dhe unë ... do të them!...

## RUBAIRAT

Atdhe i imi! Dashuria ime ndaj teje asgjë nuk më dha  
Përveç drunjëve të kryqit tim!  
Atdhe, atdheu im sa i bukur je!  
Merri sytë e mi, merre zemrën time, merre...  
të dashurin tim

\* \* \*

I këndoj tubave të miqëve të mi  
Që t'i përkundi miqtë e vegjël  
Tek unë qarkullon gjaku i gjyshit tim  
Andaj më prit natën e fundit!

\* \* \*

Oreksi i thikave nuk do t'e kuptoj aromën e zambakëve  
E i dashuri im nuk flen ...  
Do të këndoj, edhe poqëse tribuna e poezive të mia  
bëhet trekëmbësh  
dhe për njerëzit shpëtim ...

\* \* \*

Poezia më e bukur është ajo që çdo lexues  
e ruan thellë në zemër ...  
dhe kur nuk e pijnë njerëzit ...  
thuaj unë vet jam gabim...

\* \* \*

Dëshirojmë t'i shtrëngojmë grushtat dhe të shkojmë  
Kur të na merr uria t'e ndajmë bashkë pogaçën  
Netëve të ftohta të mbuloj me qirpikët e mi  
Dhe me çmime që sillen rreth diellit!!

\* \* \*

Gjëja më e bukur është të pijmë çaj në mbrëmje  
Dhe t'u tregojmë përralla fëmijëve  
E nesër nuk takohemi fshehtas  
Dhe nga gëzimet qajmë!!

\* \* \*

Nuk e dua vdekjen derisa në tokë ka ende vjersha  
E sytë nuk flejnë!  
Nëse ka ardh apo nuk do të vij me leje nuk do të kundërshtoj  
Por do ta lus atë të vajtoj përfundimin.

\* \* \*

Nuk kam ku të flej  
Nuk kam shtrat që ta shtrij në dy brigjet  
Sezona kaloi e ajo pa përshëndetur fare tha:  
Zotëri, nëse ke të m'i japish njëzet funta!!

## KORRIKU DHE GJARPËRI

Korriku kaloi nëpër gërmadhat tona  
E nxiti oreksin e gjarpërit  
E gruri korret për herë të dytë  
E kullosat janë të etura për vesë

Korriku u kthye për t'i shlyer kujtimet e hidhura  
Etjen dhe gurët nga zjarri  
E i mërguari pyeti :  
Si t'i kem në duar të mbjellat  
Në shuplakë që e helmon ujin e puseve të mia?

Fëmijët në mërgim pyetën:  
Babatë tonë këtu i kaluan netët  
Duke na i përshkruar mburrjet tona të arta  
Folën shumë për hardhitë e rrushit, për pluhurin  
Korriku u kthye, e ne nuk e vërejtëm

U ngritën të burgosurit: Ishe për ne  
Shumë bujar o zjarr i korrikut  
I lirë si drita e diellit dhe rëra  
E sot, me afsh i rrezistojmë kamxhikut dhe shtypjes

Korriku u largua prej lëmave tona  
Korriku me vete e mori flakën e vet  
Por, në gërmadhat tona mbeti  
Gjarpëri

E në fytat tonë shkaktoi

Etje

E në gjakun tonë...

Afsh dhe hidhërim të amshueshëm

## BURGU

U ndërrua adresa e shtëpisë sime  
Edhe orari i ushqimit tim  
Ndryshoi edhe sasia e duhanit  
Edhe ngjyra e teshave të mia,  
Edhe fytyra edhe pamja ime  
Bile edhe hëna  
I dashur jam unë këtu...  
Familja ime u shtua edhe më  
Toka kundërmon erë të këndshme  
Ushqimi i rëndomtë është sheqeri  
Më duket se jam në pullazin e shtëpisë sime të vjetër  
Dhe ylli i ri ...  
Më ndau të më lidh në pranga

**TELEGRAM NGA BURGU**

Nga fundi i burgut u përhap nama e poezive të mia  
Era në zjarr ua shtrëngon duart

Unë jam këtu, prapa murit  
E drunjtë e mi i nënshtrohen kodrës së trilluar

Qysh kur kam ardh paguaj kompenzim për shkronjat  
Në gjembat e mureve të mi ngrihen vetëm yjet

Prangave të forta në duartë e mia u them:  
Këto janë mure të vjershave të mia dhe  
të rezistencës sime

Jua ngritëm famën tuaj, e prangat në duar  
Gjatë tërë jetës tuaj ishin përplot njolla

U them njerëzve, miqëve: ne jemi këtu  
Robëria ime është dashuria juaj në procesionin që ecën

Ditën, me vite u rrit dashuria ndaj atdheut tim  
Më përqaftuan dëshprimet e erës në zjarr

**ME MUHAMEDIN**

- Alo ...  
- E kërkuj Muhamedin arab  
- Po! Kush je ti?  
- I burgosur në atdheun tim  
Pa tokë  
Pa flamur  
Pa shtëpi  
E detyruan popullin tim të mërgoj  
Dhe erdhën të blejnë zjarr nga zëri im  
Që del nga errësira e burgut ...  
Ç'të bëj?  
Rrënoje burgun dhe rojtarët  
Dhe me të vërtetë bukuria e besimit  
e shkrin të idhtit e Handhalit\*.

\* . Një bimë e idhët që rritet në tokat arabe. Në popull tek arabët përdoret shprehja: i idhët si handhali (shënim i përkthyesit).

**PJESA E MBETUR E POEMËS**

Më leni të plotësoj poemën  
sepse ajo është dhuratë e gjyshërve për nipat:  
"Ne e kemi mbjellë e ju korrne"  
Zëri na vie nga plehëri  
e ngop Saharën me shi  
dhe gjelbëron drurin e thatë!

Më leni ta plotësoj poemën

## E PAMUNDURA

Po vdes duke dëshiruar  
po vdes duke u djegur  
I varur po vdes  
i therur po vdes  
Por nuk them:  
Kaloi dhe u zhduk dashuria jonë  
Dashuria jonë nuk vdes

**POEMA E BURRAVE**

Në bregun më të bukur po shkoj  
mos qaj për këmbët e mia  
ato janë prej hekuri  
hapërimet e mia janë si të diellit  
ato i forcon gjaku im.

Në bregun më të bukur po shkoj  
mos u brengos për zemrën time  
ajo është e piratëve ...  
zemra ime është e ngjyrosur me dheun tim  
që kundërmon erë dashurie  
dhe barut i urrejtjes!

Në bregun më të bukur po shkoj  
e nuk ndalem  
mos u ngutuni për të fjetur, unë dridhem  
e shtrati për ata që flenë  
është prej dërrasave të tabutit  
dhe gjendet në gjysmë të rrugës!  
Ejani o shokë udhëheqës të shqetësuar  
të shkojmë  
të shkojmë në bregun më të bukur  
nuk do të shkatërrohemi  
dhe nuk do të humbim gjë  
pos tabutit!

\* \* \*

Përpjetë  
ngrihen gërklanet tona  
Përpjetë  
ngrihen guroret tona  
Përpjetë  
ngrihen këngët tona  
Nga trekëmbëshi dhe kryqet tona  
të tanishmes dhe të së kaluarës sonë do të ndërtojmë  
shkallë për të nesërmen e premtuar  
Atëherë do të klithim: O Rizvan\*  
Hape derën tënde të mbyllur!  
Do t'i nxjerrim nga gërmazet tona  
dhe nga akuzat e të mjeruarve  
vjershat si verë të ëmbël  
dhe përnjëherë do t'i pijmë në kafenetë tona  
dhe do të këndojmë rrugëve  
në gurore  
në ferma  
në klubet tona!  
Do të përqëndrohemi në guroret tona  
prej nga shikohet më larg, më thellë dhe më mirë  
dhe nuk do të shpërndahe mi  
pos në mëngjes  
dhe nuk do të dëgjojmë  
pos fitores  
dhe çdo trazirë në rruzullin tokësor  
na dridh  
dhe çdo bukuri në botë

\* Emër i parajsës (shënim i përkthyesit).

e puthim  
dhe nga çdo kopsht në tokë  
hamë çdo kokërr  
dhe çdo vjershë në tokë  
nëse vallëzon e përqafojmë  
dhe çdo jetimi në tokë  
nëse na thërret i përgjigjemi  
do të dalim nga të dehurit tonë  
dhe nga mërgimi ynë  
do të dalim nga vendstrehimet tona  
do të na marrin erë armiqtë tanë:  
"Ja .. barbarët, ata janë .. arabë"  
Po arabë  
dhe nuk turpërohem  
Ne dijmë si duhet shtrënguar  
dorëzën e sopatës  
por edhe si t'iu kundërvihemi duarthatë.  
Po ashtu dimë si të ngrisim  
fabrika moderne  
edhe shtëpi ...  
spitale  
shkolla  
si të krijojmë bomba  
e raketa  
dhe muzikë  
dhe i shkruajmë poezitë më të bukura  
Zëri:  
Dhe çka pastaj?  
E dëgjuam zërin tënd të lyer me fosfor  
e dëgjuam atë,

si do t'i krijosh fjalët,  
kolibet e errëta prej qelqi  
e rruga jote e tëra është me pluhur  
dhe populli yt ...  
lotët qajnë kohën e ndritshme  
dhe toka jote ...  
e end qëllimin  
në rrugët e braktisura  
e ti nuk ke as për shpenzime të rrugës  
Dhe çka pastaj? Çka pastaj?  
I bukur është zëri yt i bartur me erën e veriut  
Po ne u mërzitëm!

Përgjigja:

I but je si asfalti  
I but je  
Ti që të mbrojnë perdet e mërzitshme  
I marrë je ti ... si hëna  
dhe i kryqëzuar në guri  
Më le t'i plotësoj poemat  
Më le të barti erën e veriut  
Më le t'i mbylli fortunat në mëngën time  
Më le ta vej dinamitin në gjoksin tim  
I but je ti si asfalti  
dhe si hëna ...  
ti je i marrë!

**IMPROVIZIMI NË UJË**

Prapa vjeshtës së largët  
Tridhjetë vite janë  
Dhe fotografia e Ritës  
Dhe tulipani që e plotësoi jetën e saj  
Në postë  
Prapa vjeshtës së largët

Të dua sot ... dhe shkoj  
Zogjtë fluturojnë me emrin tim  
Dhe vdesin.  
Të dua sot  
Dhe qaj  
Sepse je më e bukur se fytyra e nënës time  
Dhe më e bukur  
Se fjalët që më dëbuan ...

Në ujin e fytyrës sate  
Hija e natës  
Lufton me hijen time  
Dhe nuk më lejojnë sonte të shkoj  
Dritaret tona.  
Vallë, kur do të venitet lulja në kujtim?  
Kur do të gëzohen të huajt?  
Që të mundem ta përshkruaj për një çast lundrimin  
Në ujë -  
Si legjendë ose si qiell ...

... Dhe nën qiellin e largët  
Të harrova  
Rriten zymbylat  
Atje ... pa shkak  
Dhe pushkët  
Atje ... nuk janë të mllfosura  
Edhe vjersha atje  
Atje ... është pa poet  
Kurse qielli i largët  
Ngjitet me pullazët e shtëpive  
Në kapelat e policëve  
Dhe ballin ma merr ...  
Në natën e çuditshme  
U munduam ta shndërrojmë në portokall  
Dhe ik nga unë.  
Të dua  
Derisa horizonti shndërrohet në pavendosshmëri  
Të dua  
Derisa deti është i kaltërt  
Të dua  
Derisa bari është i gjelbërt  
Të dua - zanbakë  
Të dua - thikë  
Të dua sot  
Kur e dij datën e vdekjes sime  
  
Të dua sot  
Pa vetëvrasje  
Prapa vjeshtës së largët

I krehi flokët tua.  
E vizatoj belin në erë...  
Si yllin, si festën...  
Të dua sot  
Të dua pranë vjeshtës së largët  
Zogjtë kalojnë me emrin tim  
Të lirë  
Me emrin tim kalon dita  
Si kopsht.  
Me emrin tënd jetoj  
Dhe jetoj ...  
Prapa vjeshtës së largët.

**KOPSHTI I FJETUR**

E përvodha dorën time kur atë  
 e kishte kapluar gjumi  
 I mbulova ëndërrat e saj  
 Shikova mjaltën  
 që fshihej prapa vetullave të saj  
 U luta për këmbët e saj të çuditshme  
 Iu përula impulsit të saj të ngritur  
 Pashë grurin e fjetur në mermer  
 Qante një pikë e gjakut tim  
 Dhe u dridha...  
 Kopshti flen në shtratin tim.

Shkova te dera  
 Nuk u drejtova kah shpirti im  
 që vazhdonte të flejë  
 Dëgjova zhurmën e hapave të saj të vjetër  
 dhe zilet e zemrës sime  
 Shkova te dera  
 Çelësi i saj është në çantën e saj  
 E ajo flen si melaqe që çon dashuri  
 Natë me shi në rrugë, nuk vjen asnjë zë  
 Pos impulsit të saj dhe shiut.

Shkova te dera  
 Dera hapet  
 Dal.

Mbyllet dera  
Pas meje del hija ime.  
Përse them mirëupafshim?  
Prej tash u bëra i huaj për kujtimet  
dhe shtëpinë time  
U lëshova shkallëve  
nuk vjen asnjë zë,  
pos impulsit të saj dhe shiut  
Edhe hapi im lëshohet shkallëve  
Prej duarve të saj deri te dëshira për udhëtim.

Arrita te një lis  
Këtu më puthi  
Këtu më goditën rrufetë prej  
argjendi dhe karanfli.  
Këtu fillonte bota e saj  
Këtu përfundonte bota e saj.

I ndala sekondat  
Heca  
U hamenda pak  
Pastaj eca  
I mora me vete hapat e mi dhe kujtimin tim  
të këndshëm  
Eca me vetveten.

Nuk ka ndarje e as nuk ka lis  
Flinin afshet prapa dritareve tua  
Flinin të gjitha marrëdhëniet

Flinin të gjitha tradhtitë prapa dritareve tua  
Po ashtu flinin edhe agjentët...

Edhe Rita flen... flen dhe i zgjon  
ëndrrat e veta  
Në mëngjes do të marrë puthjen e vet  
Dhe ditët e veta  
Pastaj më sjell kafënë time arabe  
Dhe kafënë e saj të bardhë  
Për të njëmijtën herë pyet për dashurinë tonë  
Dhe përgjigjem  
Se unë jam dëshmitar i dy duarve  
Të cilat ma përgatisin kafënë time  
në mëngjes

E Rita flen... flen dhe i angazhon ëndrrat e veta  
- Të martohemi  
Po  
- Kur  
Kur tulipani të rritet  
Në kapelat e ushtarëve.

Hecja sokaqeve, trotuarëve pranë  
postës, kafeneve  
klubeve të këngëtarëve dhe  
sporteleve ku shiten biletat  
Të dua Ritë. Të dua. Fli dhe shko,  
pa arsye si zogjtë e vrazhdë që shkojnë  
Të dua Ritë. Të dua. Fli  
Do të pyes pas dimrit të trembëdhjetë

Do të pyes:  
Vallë a flen ende  
Apo je zgjuar nga gjumi...  
Ritë, të dua Ritë  
Të dua...

## RITA DHE PUSHKA

Mes Ritës dhe syve të mi është pushka  
Ai që e njeh Ritën e nderon dhe i përulet  
i adhuron sytë e ëmbël si mjalta!

... Dhe unë e kam puthur Ritën  
Kur ishte e vogël  
Më kujtohet kur u mbështet për meje  
dhe flokët e saj ma mbuluan shpinën  
E kujtoj Ritën  
Ashtu siç e kujton zogu moçalin e vet  
Ah ... Rita  
Mes nesh ka miliona zogj dhe fotografi  
dhe shumë takime  
Në to hapi zjarr ... pushka

Emri Rita ishte mburrje e gojës sime  
Trupi i Ritës ishte dasmë në gjakun tim  
Edhe pse i kam humbur dy vite me Ritën  
E ajo ka fjetur mbi gjoksin tim dy vite  
Premtuam njëri tjetrit gotën më të bukur  
dhe i dogjëm buzët në verë  
dhe lindëm dy herë!

Ah ... Rita  
Çka i largoi sytë tu nga sytë e mi  
pos dy kotjeve

dhe reve ngjyrë mjalti  
para kësaj pushke  
Ishte çka ishte  
O heshtje e mbrëmjes  
Hëna ime në mëngjes shkoi larg  
në sytë ngjyrë mjalti  
dhe qyteti  
i fshiu të gjithë këngëtarët dhe Ritën  
Mes Ritës dhe syve të mi ... është pushka

**ZOGJTË VDESIN NË XHELIL**

- Pas pak kohe do të takohemi  
 Pas një viti  
 Pas dy vitesh  
 Dhe pas një gjenerate...  
 Dhe i fotografoi  
 njëzet kopshte  
 dhe zogjtë e Xhelilit  
 Vazhdoi ta kërkoj përtej detit  
 Domethënien e re për të vërtetën  
 Atdheu im është litar për terjen e  
 faculetave që u zhytën në gjakun e derdhur  
 në çdo minut  
 Dhe u shtrira në bregdet  
 në rërë buzë hurmave .

...Ajo nuk din -  
 Ritë, unë dhe vdekja ishim bujar ndaj teje  
 Fshehtësia e gëzimit të venitur në hyrje të doganës  
 U përsëritëm unë dhe vdekja  
 në frontin tënd të parë  
 dhe në dritaret e shtëpisë sate.  
 Unë dhe vdekja jemi dy fytyra -  
 Përse pra po ikë tashti nga fytyra ime  
 Përse po ikën?  
 Përse po ikë nga ai që grurin e bënë qepalla të tokës  
 nga ai që vullkanin e bënë fytyrë tjetër për jaseminin?..

Përse po ikë?  
Asgjë nuk më mundonte natën pos heshtjes së saj  
kur shtrihej para derës  
si poet... si lagje e vjetër  
Le të bëhet ashtu si don ti - Ritë  
Heshtja ishte sopatë  
Ose kornizë e yjeve  
Ose klimë për lindjen e drunjëve  
Unë përnjëpherë e thithi puthjen  
nga mprehtësia e thikave  
Eja t'i takojmë masakrës!...  
Ra si fletët e tepërta  
Kolona e zogjëve  
në puset e kohës.  
E unë i shpëtoi krahët e kaltërt  
Ritë  
Unë jam dëshmitar i varrit që po rritet  
Ritë  
Unë jam ai që i hap prangat  
në lëkurën time  
në formë të atdheut ...

## NJË POEMË

Buzët i ke mjalt ndërsa duart  
Gotë vere  
Për të tjerët

\* \* \*

Drunjtë e mëdhenj janë freskues të pyllit të gjelbërt  
Grabuja është e vogël  
Për të tjerët  
Mëndafshi i gjoksit tënd është vesë e karizantemë  
Shtrati i këndshëm  
Për të tjerët

\* \* \*

Unë qëndroj në muret tu të zi  
Jam etje e rërës dhe shkatërrues i zjarrit  
Kush ta mbyll derën kur unë mungoj?  
Cili tiran cili djallë!!

\* \* \*

Do t'e dashuroj mjlatën tënde  
Edhe pse ajo mjaltë po i mbush gotat e të tjerëve  
Oj bletë  
Nuk ke puthë tjetër pos buzëve të jaseminit

## NË SHKËMB HINGËLLOJNË KUAJT

Në shkëmb hingëllojnë kuajt  
të zbresin apo të ngjiten?  
Të dashurës time fotografinë ia përgatis  
dhe nëse vdes le ta var në mur  
A kemi ne mur, do të pyet ajo?  
Do ta ngrejme një mur për ty, i them  
Ku? Në cilën shtëpi?  
Do ta ngrejme shtëpinë tënde, i them  
Ku? Në ç'vend?  
Nga kuja jonë u krijua kënga

Në shkëmb hingëllojnë kuajt  
Të zbresin apo të ngjiten?  
A i nevoitet asaj toka në të tridhjetat  
që ta ruajë fotografinë e kalorësit të saj në kornizë  
A mund të ngjitet  
Në majë të kësaj kodre të vështirë  
që ta shohë humnerën  
ose murin  
a udhëkryqin e përgjysmuar?  
Ah, ah çfarë udhëtimi!  
Vazhdimisht na gëlltit trimat  
Ktheja të dashurës fotografinë time  
Kur për ty të hingëllojë kali i ri  
Shqyeje fotografinë time  
Në shkëmb hingëllojnë kuajt  
Të ngjiten dhe le të ngjiten ...

**KËTU JEMI NE**

Këtu jemi ne  
Ja këtu afër  
do ta shpërthejmë rrethimin  
së shpejti  
t'i çlirojmë retë  
që të udhëtojmë me to.

Këtu jemi ne  
ja këtu pranë  
tridhjetë dyer janë  
për një frymë  
tridhjetë dyer  
ju mësojmë të na shihni  
të na njihni  
dhe në paqë  
ta shijoni gjakun tonë

Këtu jemi ne  
në ne  
qielli i gushtit  
e deti i majit  
dhe liria për njerëz

Ne nuk kërkojmë det  
Kërkojmë të tërhiqemi nga ajo  
kaltërsi  
përreth tym

Këtu jemi ne  
ja këtu afër  
tridhjetë forma  
tridhjetë hije  
për një yll ...



dhe ia arrita. U orvata ta shkruaj emrin i cili i përgjigjet turpit të ullirit - dhe u shumuan yjtë.

Të dua edhe atëherë kur them se nuk të dua  
Fytyra ime po vyshket  
Një lum i largët po e shkatërron trupin tim. Në treg e shitën  
Gjakun tim si supë të konzervuar.  
Të dua kur them se të dua -  
Ti grua që e ke vendosur bregdetin e detit mesdhe  
në gjoksin tënd  
Kopshtet e Azisë mbi supet tua  
Dhe të gjitha ujërat e pijshëm në zemrën tënde  
Të të dua apo mos të të dua -

Përrockat po gurgullojnë, era e ngrohtë udhëton,  
Detërat janë trazuar dhe puplat e djegura të bilbilëve  
Në gjakun tim  
Atë ditë që të pashë dhe shkova

\* \* \*

Të të këndoj apo mos të të këndoj -  
Po heshti. Po klithi. Nuk ka termin për klithje  
E as që ka termin për heshtje  
E ti je klithja e vetme dhe heshtja e vetme.  
U gërshetua lëkura ime me thikën time  
Nën dritaren time kaloi era e kontrolluar  
Dhe tiranët pa kohë të caktuar  
Sa herë që zbresin me ushtrinë.  
Do të shkruaj diç ...  
Kur të kalojnë ushtarët pranë meje.

Do të largohem pak ...  
Dhe kur ushtarët largohen prej syve të mi  
Të shoh ty ... sërish e shoh shtatin tim.  
Të të këndoj apo mos të të këndoj  
Ti je këngëtarja e vetme dhe  
Nëse heshti ti më këndon mua  
Dhe ti je heshtja e vetme.

2

Në ditët e sotit  
E gjej veten të ngurtë  
Si drurin që ngritet në libra  
Kurse era e përcjell pyetjen  
Luftoj apo nuk luftoj?  
Nuk është kjo ajo pyetje  
Me rëndësi është të jetë e fortë thika ime  
Punoj ... apo nuk punoj?  
Nuk është kjo ajo pyetje  
Me rëndësi është tetë ditë në javë të pushoj  
Sipas llogaritjes palestineze të kohës  
O vatan i kënduar e i masakruar shumë  
Më drejto në prejardhjen e vdekjes  
A është kjo thikë apo mashtrim?

\* \* \*

Për të m'u kujtuar se kam pullaz të humbur  
Më duhet të rri nën qiell të hapur  
Për të mos e harruar puhinë e pastërt të atdheut  
Duhet të marr frymë si tuberkuloz

Për ta kujtuar gazelën e bardhë e të shpejtë  
Duhet të mbyllem në kujtime  
Për të mos harruar se kodra ime është e lartë  
Duhet ta shlyej furtunën nga balli im  
Për ta ruajtur mbretërinë e qiellit tim të largët  
Nuk më duhet gjë pos lëkurës sime

\* \* \*

O vatan i masakruar e i kënduar shumë  
Përse të kontrabandoj nga aeroporti në aeroport  
Si opijumin ...  
Si boja e bardhë ...  
Si radioja?!

\* \* \*

Dua ta vizatoj portretin tënd  
O ti i humbur në mapa të sulmeve  
Dua të ta vizatoj portretin  
O ti që fluturon me copa të bombave dhe  
me krih të zogjëve  
Dua të ta vizatoj portretin  
Por qielli m'i ngatërron duart.  
Dua të ta vizatoj portretin  
Ti i rrethuar mes erës dhe thikës  
Dua të ta vizatoj portretin  
Dhe në ty ta gjej portretin trim  
Më akuzojnë për ndarje  
Falsifikim të dokumenteve dhe  
fotografive të diellit  
Ti i rrethuari mes erës dhe thikës.

\* \* \*

O vatan i kënduar dhe masakruar shumë  
Si po shndërrohesh në ëndërr e e vjedh tmerrin  
Që mua në gurë të më përqëndrosh  
Ndoshta më i bukur je kur shndërrohesh në ëndërr  
Ndoshta je më i bukur!.

\* \* \*

Nuk ekziston në historinë arabe  
Asnjë emër që do ta përvetësoja  
Dhe me të fshehtas të të vij nën dritare  
Të gjithë emrat e fshehtë janë të ndaluar  
Në byrotë për rekrutim  
A e pranon pra emrin tim -  
Emri im është fshehtësia ime e vetme -  
Mahmud Dervish  
Kurse emrin tim të vërtetë  
Me mish ma kanë këputur  
Kërbaçët e policisë

\* \* \*

O vatan i masakruar dhe i kënduar shumë  
Më drejto në burimin e vdekjes?!  
A është kjo thikë  
Apo është mashtrim?!

3

Atëherë kur fjalët më ishin  
Dhé.....  
Isha shok i kallinjëve.

Atëherë kur fjalët më ishin  
Hidhërim ...  
Isha shok i zinxhirëve.

Atëherë kur fjalët më ishin  
Shkëmb ...  
Isha shok i regjistrave.

Atëherë kur fjalët, më ishin  
Rebelim...  
Isha shok i tërmeteve.

Atëherë kur fjalët më ishin  
Bashkëbisedime...  
Isha shok i optimistëve.

Kur fjalët e mia u bënë  
Mjalt ...  
I mbuluan mizat  
Buzët e mia!..

4

E lash fytyrën në faculetën e nënës  
Dhe në kujtime i barta kodrat  
E ajo shkoi ...

Qyteti i thente portat e veta  
Në detin e hapur tubohen anijet  
Si gjelbërimi në kopshtet që po humbet

Unë mbështetem në erë  
 O siluetë e pathyeshme  
 Përse po luhatem kur ti je mbështetja ime

Largësia më kalit  
 Si e kalit vdekja e freskët fytyrën e dashnorëve  
 Sa më shumë që u afrohem yejve  
 Aq më shumë shkatërrohem ...  
 O koridore në hapësirë të zbrazët  
 Kur do të arrij?..

I lumi ai që është nën lëkurën e vet!  
 I lumi ai që pa gabim e kujton emrin e vet të vërtetë!  
 I lumi ai që e ha mollën e nuk shndërrohet në dru.  
 I lumi ai që pi ujë të lumenjëve të largët  
 Dhe nuk shndërrohet në re qielli!  
 I lum shkëmbi që robërinë e vet e shkatërro  
 Dhe nuk e pranon lirinë e erës!

5

Athua sa herë që reja në mur ndalet  
 Fytyra ime i fluturon si dritare e thyer  
 Po harroj se jam i magjepsur në harresë  
 Dhe se e kam humbur identitetin?

Unë i pranoj të shtënat  
 Si agimi ...  
 E sytë e mi shohin më largë se të profetëve  
 O ju dete që u është mërzhitur ngjyra e juaj më ndjekni

T'ua tregoj një shkop\* tjetër.  
Unë i pranoj çudirat  
Si lindja ...

Jam i zhgënjyer  
Kur nuk mund të klithi  
A e quani murmurimën murmurimë dhe vetimën vetëtimë  
Kur zëri u shtangohet dhe shkëlqimi u humbet  
A sa herë që dal nga lëkura  
Dhe nga hapësira e pleqërisë  
Shumohen hijet dhe më mbulojnë...?  
A sa herë që si era vrapoj nëpër rërë  
Duke kërkuar kalorësit e humbur  
E gjej vetëm fytyrën time të vjetër që e kam lënë  
Në façuletën e nënës?

I gatshëm jam për vdekje  
Si rrufeja...

6

Drujtë e vendit tim merren me gjelbërim  
E unë merrem me kujtime,  
Ndërkaq zëri i humbur në shkretëtirë  
Drejtohet kah qielli dhe klith:  
O re! Ai po kthehet?

\*. Mendohet në shkopin e profetit Musa (Mojsiut), me të cilin ai ka krijuar urën në detin e kuq dhe e ka shpëtuar popullin e tij ebrej nga ndjekja e ushtrisë së Faraonit (shënim i përkthyesit).

Nuk jam aq shumë i brengosur  
Por zogjtë nuk i don  
Ai që drunjtë nuk i njeh.  
Dhe nuk e njeh befasinë  
Ai që merret me mashtrime.  
Nuk jam aq shumë i brengosur  
Por nuk e njeh mashtrimin  
Ai që nuk njeh frigë.

Nuk jam aq shumë i mbyllur  
Por drunjtë janë të lartë.  
Zonja, gra dhe zotërinjë  
Unë i dua zogjtë  
Unë i njoh drunjtë  
E njoh befasinë  
Sepse nuk di të mashtroj  
I mprehtë jam si e vërteta dhe si thika.

Për këtë ju lus:  
Shtini në zogjtë  
Që t'ua përshkruaj drunjtë.  
Ndalne Nilin  
Që t'ua përshkruaj Kajron.  
Ndalne Tigrin ose Eufratin, apo të dytë  
Që t'ua përshkruaj Bagdadin.  
Ndalne Berdën\*  
Që t'ua përshkruaj Damaskun.  
Dhe m'i ndalni fjalët mua  
Që t'ua përshkruaj veten ...

\*. Lum në Siri (shënim i përkthyesit).

7

Hija e hurmave, dëshmorët tjerë dhe  
Radjoja çdo ditë krijojnë fotografinë e zëshme  
Të gjendjes së shokëve  
Të dua në vjeshtë dhe në dimër.

Haifa nuk qan. Ti qan. Ne nuk harrojmë  
Copëtimin e qytetit ...  
Dhe ti. Jo. Deti nuk hynë kështu në shtëpitë tona  
U fundosën pesë dhoma  
Kurse qielli dhe pullazet me dru të thatë bubullojnë.

Më burgosën. I lumtur ishte në luftën e lirë.  
Ah vatan i karanfilit dhe pistoletës, nëna nuk ishte me mua.  
Pas asaj kohe shkova të të kërkoj në radio  
Pamja e jote më trishtonte ... më mbuloj pluhuri.

Hija e hurmeve, dëshmorët tjerë dhe radjoja  
Çdo ditë krijojnë fotografinë e zëshme  
Të gjendjes së shokëve  
Të dua në vjeshtë dhe në dimër

8

O vende të emrave që ua din natyrën e emrave  
Të njohura për kërbaçët e historisë  
Dhe për burgjet e historisë  
Dhe për llogoret e historisë.  
O ju vende të harruara me shekuj

Përse e provokoni veten me këto avantura?  
 Përse veten po e shpallni  
 Embrion botëror?  
 Dhe përse je e bukur përtej mase?  
 Bile edhe më tepër:  
 Përse nuk po hjekni dorë nga unë  
 Që t'i shmangem vdekjes ...

O vende të forta si gjumi  
 Thuani një herë:  
 Mori fund dashuria jonë.  
 Që të bëhem i aftë për vdekje .. e për shkuarje.  
 Ua kam zili erërave që papritmas vërshojnë  
 Rërën e etërve të mi  
 Por vetit nuk ia kam zili .  
 Po ma vërshoni trupin si djersa  
 Po ma vërshoni trupin si kënaqësia  
 Po ma bllokton kujtesën si okupatorët  
 Mendjen po ma okupon si dritën  
 Vdisni ... që t'u vajtoj  
 Ose bëhuni gra të mijat  
 Që tradhëtinë ta mësoj  
 Një herë

9

Oj lule që qëndron jashtë kohës dhe ndjenjës  
 O puthje në faculetat e erërave...  
 Më befasoi me një ëndërr  
 Që nga çmenduria ime të liroi!

U largova prej teje  
Që të të afrohem  
Dhe e gjeta kohën.

T'u afrova  
Për të t'u larguar  
Dhe e gjeta ndjenjën.

Mes të të larguarit dhe të afruarit  
Është një guri i madh sa ëndrra  
Mos u afro  
Mos u largo  
As ti o vendi im

As unë nuk jam guri  
Për këtë arsye nuk shtrihem përballë diellit  
E as përballë tokës  
Dhe mbetem i huaj ...

10

Moment i gjatë i agonisë  
Më kthen në rrugën e fëmijërisë  
Më fut nëpër shtëpia  
Në zemra  
Në kallinjë  
Ma kthen identitetin  
Më shndërron në problem  
Moment i gjatë i agonisë

\* \* \*

I është dukur atyre  
Se jam i vdekur dhe  
se jam i denuar për shkak të këngëve  
Shkuan e as që ma nxunë në gojë emrin  
Ma varrosën trupin në paketa  
Dhe shkuan.  
( Ndërkaq, vendet që i kam ëndërruar  
Do të mbeten vende të ëndërruara)  
Jeta qe e shkurtër  
E vdekja e gjatë  
U enda pak  
Në trupin tim e shkrova emrin e atdheut tim  
Kurse për pushkën  
Thash: kjo është gruaja ime  
Kjo është udhërrëfyesja ime  
Për qytetet bregdetare.  
Dhe u nisa,  
Por ata më vranë.

\* \* \*

Trupin ma varrosën në disa pakete  
Dhe shkuan ...  
Kurse vendet që i ëndërroja  
Do të mbeten vende të ëndërruara

\* \* \*

Unë jam gjatë në agoni  
Jam zotëri i pikëllimit...  
Derisa lotojnë arabet e dashuruara

Dhe tubohen rreth meje këngëtarët dhe oratorët  
Nga kufoma ime rriten poezitë dhe liderët  
Dhe të gjithë oratorët nacional  
Duartrokasin  
Duartrokasin  
Duartrokasin  
Andaj le të jetojë  
Momenti i agonisë së gjatë

\* \* \*

Momenti i gjatë i agonisë  
Më ktheu në rrugët e fëmijërisë  
Më futi nëpër shtëpi, zemra, kallinjë...  
Më shndërroi në problem  
Ma krijoi identitetin  
Dhe prangat si trashëgim.

11

Nuk më mbetet tjetër gjë  
Pos të bredh me hijen tënde e cila është edhe hija ime  
Nuk më mbetet tjetër gjë  
Pos të mbështetem në zërin tënd i cili është edhe zëri im.

U rrokullisa nga kryqëzimi që është i tejdukshëm  
Në horizontin e largët  
Deri te bregu më i vogël ku arrijnë ëndrrat  
Dhe nuk devijova për shkak të plagës dhe lirisë sime  
Meqë nuk e di se ku je  
Nuk mundem të hapëroj

Meqë nuk mbështetem në ty si në gozhda  
U shtrembërova shumë  
Si qielli yt që e përcjell fluturimin e zogjëve

Ma kthe emrin tim  
Të qeverisi me drunjtë  
Ma kthe fytyrën  
Të qevereisi me furtunat që vijnë  
M'i kthe shkaqet e gëzimit tim  
Të qeveris me shkuarjen e paarsyeshme  
Sepse zëri më është shterrur si qielli i natës  
E dorën e kam të zbrazët si himna nacionale  
Sepse hija ime është e gjerë si festë  
Dhe fytyra më copëtohet në automjetin e ndihmës  
së shpejtë  
Për shkak se jam i tillë  
Jam shtetas i shtetit të palindur...

12

E mbylla veten në vetëvete  
Sepse nuk jam spiun i shpirtit tim  
Ndërsa jasht bie shi  
Pa arsye

I lumi ai që i din kufijtë e lumturisë sime  
I lumi zotëriu që e din historinë time  
I lumi rojtari që gdhin për sigurinë time  
Me sy të dremitur  
I lumi ai që kupton se ç'domethënie ka

Se jam i burgosur dhe gardian në të njëjtën kohë.  
O dritare të largëta si dashuria e parë  
Tashmë nuk banoj në Babilon  
Por, Babiloni prehet në rrudhat e fytyrës sime  
Kudo që të shkoj.  
O dritare të largëta si dashuria e parë  
Nuk jam i mërguar  
Nga zemra e kam dëbuar mërgimin dhe shkova.

Jasht po bie shi  
Pa arsye.  
Mbrenda shpirti zgjerohet  
Për shumë shkaqe.  
Kush i rradhiti stinët e vitit ndryshe  
Kush e ndërron organizimin e kalendarit  
Kush ma mëson të qarët e Jeremiut  
Në rrugët e Jerusalemit të cilin e nemi Zoti  
Kush e shpalli i pari  
Datën e lindjes sime  
Kush?

13

Unë jam i gatshëm për shpërthim  
Buzë ëndrrës  
Si pusët e shterrura që përgatiten  
Për vërshim.

Përgatitem për çlirim  
Buzë ëndrrës

Si shkëmbi që përgatitet  
Në thellësi të minierave të vdekura

Përkatitem për vdekje  
Buzë ëndrrës  
Ashtu siç përkatitet shehidi për vdekje  
Për të dytën herë.

Përkatitem të klithi  
Buzë të vërtetës  
Si vullkani që përkatitet  
Për shpërthim (erupcion).

14

Udhëtimi mori fund -  
Kush ma fsheh të dashurën  
Si kaloi nata pa e vërejtur  
Si u fsheh  
Në sytë e të dashurës sime?  
Udhëtimi mori fund.

Miqtë po largohen prej meje  
Miqtë papritamas po vdesin

Udhëtimi mori fund  
Në krah të dallëndysheve  
Udhëtimi filloi  
Kur i burgosuri u arratis

Nuk dija për humbje  
Në zinxhirët e prangave  
E mishi më ishte i gatueshëm  
Si pullazet e shtëpive të armikut  
Por, megjithate  
Nuk dija për humbje  
Në zinxhirë të prangave

Miqtë po largohen prej meje  
Miqtë papritmas po vdesin.

15

Ik nga tehu që mi copton miqtë  
Sepse tehet më ndjekin pamëshirë  
Tehet po afrohen, afrohen  
Dhe ma prekin fytyrën.

Vështirë mund ta dini  
Ku përfundon legjenda  
Dhe ku fillon fytyra ime  
Sepse tehet janë afër!.

Këto plasaritje në ballin tim  
Nuk janë gjurmë të viteve.  
Këto vija të kaltërta nën sytë e mi  
Nuk janë argumente të pagjumësisë me gratë  
Por janë tehe që degëzohen në trupin tim.

Unë jam i gjykuar për humbje  
E armiku im është i gjykuar për fitore  
I durueshëm jam në humbje  
E armiku im i durueshëm në fitore.

O errësirë që në qytet po vjen  
Përhapu ... përhapu.  
Sepse sonte dua të iki nga fytyra plot tehe  
Në zemër  
Në të vetmin qytet që në robëri nuk është.

16

Po argëtohem me kohën  
Si princi kur e lëmon kalin.  
Po luaj me ditët  
Si fëmijë që luajnë me margaritar të ngjyrosur.

Sot, unë festoj  
Për shkak të ditës së kaluar  
Edhe nesër festoj  
Për shkak të dy ditëve të kaluara  
Ngrehi dolli për ditën e djeshme  
Duke e kujtuar ditën e nesërme  
Dhe kështu ... më kalon jeta!.

Kur u rrëzova nga kali i pafrenueshëm  
Dhe e theva këmbën  
Më dhimbti gishti i lënduar  
Para një mijë vjetëve!

Kur e shënova katërdhjetëvjetorin e qytetit Aka  
U gulfata nga qarja për Granadën  
Kur m'u shtrëngua litari rreth qafës  
Pa masë i urrejta armiqtë  
Për shkak se ma vodhën kollaren!

17

I shkruajmë Jerusalemit:  
Kryeqytetit të shpresës zhgënjyer ...  
I rebeluar i uritur ...  
Planeti që mungon, u përzie në masën e fjalëve  
të panjohura dhe u nda nga buzët e këngëtarëve  
dhe të shitësve të puthjeve të kaluara.

U ngritën në të mure të reja për nevoja të reja  
Troja u bashkua me robërit  
Shkëmbi nuk tha asnjë fjalë që do të kundërshtonte  
I lumi ai që hyn në zjarr me rastin e vdekjes!

Dhe i këndojmë Jerusalemit  
O fëmijë të Babilonit  
O të lindurit në zinxhirë  
Së shpejti do të ktheheni në Jerusalem  
Së shpejti rriteni  
Së shpejti e korrni grurin nga kujtimi i kaluar  
Së shpejti lotët bëhen kallinjë.  
Ah, o fëmijë të Babilonit  
Së shpejti do të ktheheni në Jerusalem  
Dhe së shpejti rriteni

Dhe shpejt  
Dhe shpejt  
Dhe shpejt ...  
Bashkohuni  
Bashkohuni!

**LETËRNJOFTIMI**

Shkruaj  
Unë jam arab  
Numri i letërnjoftimit tim është pesëdhjetë mijë  
I kam tetë fëmijë  
E i nënti është në rrugë  
Do të vijë pas verës!  
A po hidhërohesh?

\* \* \*

Shkruaj  
Unë jam arab  
Dhe me shokët e mi me mund punoj në gurore  
Dhe për tetë fëmijët e mi  
E nxjerr kafshatën e bukës  
Veshmbathjen dhe fletoret  
Nga shkëmbi ...  
Dhe nuk kërkoj lëmoshë nga dora jote  
As fëmijët  
Para pallatës sate nuk kërkojnë lëmoshë  
A po hidhërohesh?

\* \* \*

Shkruaj  
Unë jam arab  
Kam emër por jo edhe mbiemër  
Jam i durueshëm.

I kam shpërnda rrënjët e mia  
 Në vendet që vlojnë nga hidhërimi.  
 Rrënjtë e mia ...  
 U shfaqën para erës së re  
 Para një periudhe të gjatë  
 para qiparisit dhe ullinjëve  
 para përhapjes së gjelbërimit  
 babai im rrjedh nga familje lavërtari  
 e jo nga zotërinjtë aristokrat  
 Edhe gjyshi im ishte bujk  
 pa prejardhje aristokrate  
 Më mëson mua për ngritjen e diellit para leximit të librave  
 dhe shtëpia ime, rojtar në errësirë  
 prej krondeve dhe prej rogozit  
 A të kënaq kjo gjendje e ime?  
 Unë kam emër por jo edhe mbiemër!  
 A po kënaqesh nga kjo gjendje e ime?

\* \* \*

Shkruaj  
 Unë jam arab  
 Ngjyra e flokëve: e zezë  
 Ngjyra e syve: ngjyrë kafe  
 Karakteristikat e mia:  
 Në kokë kam kapelë dhe mbi te shaminë  
 Dhe lugina të forta si shkëmbi ..  
 Që shqyhet nga kontakti me te  
 Dhe adresa ime :  
 Unë jam nga fshati i rrënuar. i dëbuar  
 I harruar në rrugët pa emër.

Të gjithë burrat derdhin djersë në në fushë dhe gurore  
Kan mall njerëzit  
Të jetojnë si njerëz

\* \* \*

Shkruaj  
Unë jam arab  
Ti m'i ke grabitur vreshtat e gjyshëve të mi  
Dhe tokën që e punoja  
Unë dhe gjith fëmijët e mi  
Dhe neve dhe fëmijëve të mi  
Na i ke lënë këto shkëmbinj  
E thuhet se do të na i merrni  
Edhe këto shkëmbij?!  
A është e vërtetë!

Edhe një here them!  
Edhe një here!  
Shkruaj .. në fillim të faqes së parë.  
Unë nuk i urrej njerëzit,  
Nuk e sulmoj askend.  
Por nëse mbetem i uritur shumë,  
E ha mishin e atij që ma uzurpon atdheun tim  
Kujdes nga uria ime  
Dhe nga hidhërimi im!!

Mos më hidhëro.

## REAKCIONI

Atdheu im  
çelik i prangave të mia më mëso  
tërbimin e shqiponjave  
dhe butësinë e atij që beson në Ardhmëri  
Nuk dija se nën lëkurë kemi  
lindjen e furtunës  
edhe galdimin e përronjëve  
dritën në qeli e mbyllën  
kurse në zemër digjet flakë  
dielli i pishtarëve,  
Ma shkruan numrin në mure  
dhe në mure u rrit  
fusha e kallinjve  
në mure e vizatuan figurën e gjaksorit tim  
dhe vijat ja shleu errësira  
me gjëmbë, i përgjakur ia varrosa fotografinë  
i këndova një këngë errësisrë që shkonte  
errësisrës në mish ia ngula fitoren time  
dritës në mish ia ngula gishtat e mi  
dhe portirët nga maja e dhomës sime  
e mbyllën vetëm dridhjen time  
do të shohin vetëm kriklimën e prangave të mia  
dhe në mundim të besimit nëse digjem  
si luftëtar do të kthehem në jetë.

## NËNËS SIME

Përmallohem për bukën e nënës sime  
edhe për kafënë e sajë  
edhe për përkdheljen e sajë...  
Në mua do të rritet fëmijëria  
një ditë prej ditësh  
dhe e dua jetën time sepse  
nëse vdes  
do të turpërohem nga lotët e nënës sime!

Më merr nëse një ditë kthehem  
të bëhem faculetë e qepallës sate  
m'i mbulo eshtrat me barëra  
të lyer nga dëlirësia e shpirtit tënd  
m'i shtrëngo prangat me flokë  
me penin që zvarritet nëpër cepe të teshave tua  
ndoshta do të bëhem Zot  
do të bëhem Zot  
po të ta prekja brendinë e zemrës!

Nëse fare kthehem më lerë  
të bëhem lëndë djegëse e zjarrit tënd  
dhe litar për tharjen e teshave në shtëpinë tënde  
sepse unë e kam humbur qëndrimin  
jam shkatërruar, andaj  
kthej yjet e fëmijërisë  
që prapë të jem me harabelat  
më kthe në follenë tënde të ngrohtë!

## URA

Kthehesh duke ecur këmbë  
ose duke u zvaritur me duar  
Thonë ...  
se shkëmbi po tkurret  
dhe natën dora shpie ...  
Nuk e kanë ditur se rruga është në rrugë  
gjaku, gracka, shkatërrimi  
të gjitha kolonat para tyre janë përmytur  
kurse lumi i pështyen dy brigjet  
me copa nga mishi i bluar  
në fytyrat e të kthyerve  
Ishin tre të kthyer  
plaku, vajza e tij dhe luftëtari i vjetër  
Qëndrojnë tek ura ...

(Ura ishte e fjetur, ishte natë e errët, pas disa minutave  
arrijnë, a ka ujë në shtëpi? E kërkoi çelësin, pastaj lexon një  
ajet\* nga Kur'ani)

Plaku i freskët tha: sa shtëpi janë?  
në vendin në të cilin mësohet fëmija  
Ajo tha: po shtëpi janë gërmadhat, baba!  
U përgjegj: do t'i ndërtojmë me dy duar  
dhe biseda e tyre vazhdoi derisa  
nuk dëgjoi zërin në rrugë: ejani!  
dhe i ndoqën të shtënat nga pushkët ...  
Nuk kaluan të kthyerit

\* . Verset

Kufitarët qëndrojnë  
dhe mbrojnë kufirin me dëshirë të zjarrtë

( Ka urdhëruar të hapet zjarr në ata të cilët e kalojnë këtë urë. Kjo urë është gijotinë, për ata të cilët refuzojnë të lypin lëmoshë nga një komb dhe vdekja është gratis në shi dhe nënçmim. Kush e rrefuzon vdes në këtë urë. Në urë të gijotines e cila ende ëndërron për atdheun).

Fisheku i parë fluturoi  
nga balli i natës ra  
kapela e territ  
kurse fisheku i dytë  
qëlloi zemrën e luftëtarit të vjetër  
Plaku e kapi për dore vajzën e vet  
Dhe në heshtje lexon një sure\* të Kur'anit  
me theks si në ëndërr, me sy  
të drejtuar kah yjet, tha :  
- Sytë e të dashurës sime të vogël  
janë të mitë, ushtarë edhe fytyra e saj e artë është imja  
edhe pamja e saj si princezë, gërsheta  
të miat janë, ushtarë  
e tëra është e imja,  
e kjo është e dashura ime e fundit.

\* \* \*

Erdhën tek ai ... zgërdhihen vrazhdë  
- Mos e vritni atë, më vritni mua  
Vritne të nesërmen e saj dhe lene atë pa baba  
dhe merrni haraçin për të  
tërë kopshtin dhe të hollat

\* . Kaptinë.

edhe të gjithë thasët me miell  
dhe nëse doni më vritni mua!

(E uji i lumit po shtohet ... dhe ata të cilët atje kanë rrefuzuar vdekjen pa pagesë i kanë dhënë lumit tjetër ngjyrë. Dhe kur ura do të bëhet përmendore padyshim se do të ngjyrosset me gjak të freskët të vdekjes së papritur).

Përkundrazi vrasja është si pirje duhani

Mirëpo ushtarët e mirë

të paraqitur në përmbajtjet e fletoreve

nuk i mbytën që të dytë ...

Plaku ra në lum

dhe vajza mbeti jetime

teshat në trup i ishin shkyer

dhe u përhap kundërmim i jaseminit

nga gjitë e saj lakuriq të cilët

i kishte vërshuar kundërmimi i krimit

Sërish pasoi heshtje

dhe sërish lumi i pështye brigjet e veta

me copë të mishit të bluar

... në fytyrat e të kthyerve

Nuk kanë ditur se rruga është në rrugë

gjaku dhe gracka ... dhe askush nuk e ka ditur

punën e lumit e cila

po e thith mishin e të mërguarve

(Ura është gijotinë për ata që kthehen në shtëpitë e tyre kurse heshtja është gijotinë e vetëdijes. A dëgjojnë poetët nën kapela të gurgulluarit e lumit nga gjaku, apo tash duartrokasin në ndonjë klub nudistësh sikur asgjë të mos kishte ndodhur?).

Por, zëri iku nga nata e krimit

u përhap me erërat e veta  
nëpër çdo dritare, radio dhe rrugë :  
"Sytë e të dashurës sime të vogël  
janë të mitë, ushtarë,  
edhe fytyra e saj e artë është imja  
edhe pamja e saj si priceshë edhe gërsjeta  
Mos e vritni atë, më vritni mua!"

\* \* \*

Dhe në lajmin e fundit shtoj:  
Të gjithë ata që  
kanë shkruar për gjakun dhe krimin ...  
në margjinat e fletoreve të historisë kanë thënë:  
Është marri të mendojnë sulmuesit  
sulmuesit të veshur në lëkurë të deles  
se ata i kanë vrrarë bijtë e atdheut  
Por, vajza, ajo do t'i mbulojë  
gjinjtë e saj lakuriq  
dhe do të dijë si ta mbjellë jaseminin  
kurse babai i saj i guximshëm dhe ullinjtë  
nuk do të zverdhen nga gjaku i tyre  
dhe nuk do të jetë i pikëlluar  
Andaj e vlen të shkruhet:  
Që i ndjeri e ka historinë dhe bijtë e vet!

(Ura rritet çdo ditë si rrugë dhe shpërngulja e gjakut në  
ujin e lumit i gdhend gurët dhe ndërton përmendore me ngjyra  
të yjëve dhe i therr kujtimet e shijen e dashurisë, kur të jenë më  
të mëdha se adhurimi) ...

## FJALA

Poeti arab i privuar nga gjithçka  
Gjaku i shkretëtirës shpërthen në poemën e tij  
Dhe karavanet e dëve të etura  
Udhëtojnë gjithnjë në relacionet e tyre  
Dhe këndshmëria e verdhë në sedefin e detit!

Poeti arab i privuar nga gjithçka  
Mësohet të vdes me shpatën e heshtjes së tij  
Të gjitha fshehtësitë i mbyll në sytë e tij  
Tha: Nesër do ta kuptojnë atë sytë e mi  
Dhe unë të lash ty fjalën në sytë e mi  
Por, mendoj se nuk e ke kuptuar!

**LETËR NGA MËRGIMI**

-I-

Përschendetje .. dhe puthje  
Nuk kam ç'të them më  
Prej nga të filloj? ... Dhe ku të përfundoj?..  
Koha ecën pa përkufizim  
Çdo gjë që është në te më është e çuditshme  
Gjësendet e nevojshme për udhëtim, buka bajate,  
kënaqësija e jetës  
dhe fletorja që përmban gjërat që i barti unë  
kam pështyrë në faqet e saj atë që më shtrëngoi  
mua nga smira  
Prej nga të filloj?  
Çdo gjë që është thënë e që thuhet pas të nesërme  
Nuk përfundon me bashkim ... ose me prekje me dorë  
Nuk kthehen të mërguarit në shtëpia  
Nuk bijnë shira  
Nuk rriten puplat në krihët  
e zogut të humbur .. të shkatërruar  
Prej nga të filloj  
Përschendetje ...dhe puthje ... dhe pastaj ...

-II-

I them radios ... thuaj asaj unë jam mirë  
U them zogjëve  
Nëse e takon atë o zog fluturues  
Mos harro e thuaj: jam mirë

Unë jam mirë  
 Unë jam mirë  
 Dhe ende shoh me sytë e mi!  
 Dhe ende është në qiell hëna!  
 Dhe veshja ime tradicionale deri tash nuk është shkatërruar  
 Janë shqyer këndet e saj  
 Por unë e kam harrnuar atë .. dhe ende është e mirë  
 Dhe jam bërë djalosh që i ka mbushur të njëzetat  
 Paramendmeni mua ... jam bërë njëzetvjeçar  
 Dhe jam bërë si djalosh oj nënë  
 Që i përkasin obligimet e jetës  
 Dhe barti barrë siç bartin burrat  
 Dhe punoj  
 në restorant .. dhe pastroj pjata.  
 Dhe u bëj kafe të molisurve  
 Dhe i imponoi buzëqeshjet fytyrës sime të mërzitur  
 Për t'i disponuar të molisurit

-III-

Unë jam mirë  
 Tashmë jam bërë njëzetvjeçar  
 Dhe jam bërë si djalosh oj nënë  
 Pij duhan, vrapoj nëpër mbeturina  
 Them për kënaqësi: Ah  
 Siç thonë të tjerët  
 O vëllezërit e mi, cila është vajza më e bukur,  
 Paramendonie sa idhët kalon jeta  
 Pa ata ... idhët kalon jeta.  
 Dhe shoku im tha: a keni samune?  
 O vëllezërit e mi, ç'vlerë ka njeriu

Nëse fle çdo natë .. i uritur?  
Unë jam mirë  
Unë jam mirë  
Unë kam një somune të zezë  
Dhe një sepetë të vogël me gjelbërime

-IV-

Kam dëgjuar në radio  
Përhëndetje të të mërguarve ... për të mërguarit  
Tha tuba: të gjithë ne jemi mirë  
Asnjë nuk është i mërziur  
E si është babai im?  
A e adhuron dhe e përmend ende Zotin si e kishte shprehi  
edhe profetët ... edhe dheun ... edhe ullinjët?  
Dhe si janë vëllezërit e mi  
A janë bërë nëpunës?  
Kam dëgjuar një ditë babain tim që thoshte:  
Do të bëhen të gjithë mësues ...  
Kam dëgjuar që thoshte:  
(Do të rrij i uritur vetëm t'u blej atyre libra)  
Asnjë në fshatin tim nuk din të shkruaj rrjedhshëm  
Dhe si është motra jonë  
A është rritur ... a i kanë ardhur mësitët?  
Si është gjyshja ime  
A ulet para derës ende si e kishte shprehi?  
Të na thërras neve ...  
Jam mirë .. djalosh ... dhe revolucionar!  
Si është shtëpia jonë  
ulësja e rrafshë t... oxhaku ... e dyert?  
Kam dëgjuar në radjo

Letra të të mërguarve .. për të mërguarit  
 Të gjithë ata janë mirë!  
 Por unë jam i mërzhitur ...  
 Don të më hanë mendimet  
 Nuk e bart lajmin tek ju radjoja ...  
 Edhe qofsha unë i mërzhitur  
 Edhe qofsha unë i mërzhitur

-V-

Është natë - oj nënë - vie ujku bujar  
 E dëbon të mërguarin kudo që të shkoj ...  
 Dhe hap horizonte për shpirtërat  
 Dhe lugina me shelnje ende përqafton erërat  
 Ç'marrëzi kemi bërë ne nënë?  
 Që të vdesim dy herë  
 Një herë vdesim për së gjalli  
 Dhe një herë vdesim gjatë vdekjes!  
 A din ç'më bënë mua të qaj?  
 Sëmuhem natën... dhe shkatërrohet trupi im nga sëmundja!  
 A e kujton natën  
 Një muhaxhir vie te ne. Dhe nuk kthehet në vatan?  
 A e kujton natën  
 Një muhaxhir vdes e nuk ka qefin?  
 O luginë shelnjesh a të kujtohet  
 se ai të cilin e hodhën nën hijen tënde të mërzhitur  
 - si diçka të vdekur - ishte njeri?  
 A të kujtohet se unë jam njeri  
 dhe e ruan trupin tim nga sulmi i të huajve?  
 Nënë, o nënë ...  
 Për kend i shkrova këto letra

Cila postë do t'i bart këto?  
Është mbyll rruga tokësore, detare dhe horizontet ...  
Dhe ti oj nënë  
e babai im, vëllezërit e mi, e miqtë ...  
Ndoshta jeni të gjallë  
Ndoshta jeni të vdekur  
Ndoshta jeni si unë pa adresë  
Ç'vlerë ka njeriu  
Pa vatan  
Pa flamur  
Dhe pa adresë  
Ç'vlerë ka njeriu?

## TË VRANË NË LUM

Ti dhuroj kujtimet e mia publikisht në kohë  
 Ti dhuroj kujtimet e mia  
 Çka thotë zjarri në atdheun tim  
 Çak thotë zjarri?  
 A më dashuroje  
 Apo ishe e ashpër ndaj dhunave?  
 Dhe unë jam në shtëpi të huaj në atdheun tim  
 Në shtëpi të huaj ...

Ti dhuroj kujtimet e mia publikisht në kohë  
 Ti dhurooj kujtimet e mia  
 Ç'thotë telegrami për thikën  
 Ç'thotë telegrami  
 A ke qenë në Hattin  
 Simbol për vdekjen e Lindjes  
 Unë jam Salahuddin  
 Apo rob i kryqtarëve?

Ti dhuroj kujtimet e mia publikisht në kohë  
 Ti dhuroj kujtimet e mia  
 Çka thotë dielli në atdheun tim  
 Çka thotë dielli?  
 A je ti e vdekur pa qefin  
 E unë pa shejtëri (pa bekim)?

\* \* \*

Doli nga lumi  
 Thuhet se humbet lumi dhe mali

Bukuria e saj ekzotike  
Mbështjellje e kallinjëve të grurit të vogël  
i zgjidh kërkesat e tokës.  
A ju kujtohet vera o gjenerata ime  
O gjitha lulet e Xhelilit  
Dhe gjithë jetimat e Xhelilit  
A ju kujtohet vera lëshohet nga majat e saj  
Dhe i çel të gjitha dyert.  
Manushaqja i thotë fqinjes së saj  
Kam teshti,  
Abdullahu ujiste  
E kush e mori ofendimin prej rinisë?

Doli nga lumi  
E në lum vdes ...  
E ne shtohemi në mënyrë serike  
Doli nga lumi i befasisë  
E në lum vdes me intervale kohore.  
Dhe tash kalojmë nëpër te gjenetartë pas gjenerate  
Dhe shesim ullinj të Xhelilit falas  
Dhe shesim gurë të Xhelilit  
Dhe shesim historinë e Xhelilit  
Dhe e shesim atë.  
Që të blejmë pamjen në vendin më të theksuar  
Për të vvarin duke luftuar.

\* \* \*

Nuk e pranoj dashurinë nga afër  
Le ta pranoj vdekjen time  
Dhe fëmijërinë time - Troja arabe  
Shkon ... dhe nuk vie.

Të gjitha thikat në ty  
Ngrehi ato  
O pemë limoni  
Dhe dhezi natën  
e përhap  
për qarjen e atyre që vijnë

Era qëndron në thikë  
dhe vdekja jonë është e dhembshme  
mos e shkatërro facultetën tënde të gjelbërt  
nata shkatërron

Lum ai që ka fjetë në dërrasa  
Përplot gjallëri  
Lum shpata që bëhet mbikëqyrëse  
e lumenjve të lirisë!

Nuk e pranon dashurinë nga afër  
Dhe le të hidhërohet hidhërimi  
Shkojmë në Trojën arabe  
Dhe largësia po afrohet.

\* \* \*

Mos na kujto neve  
Kur kemi dal nga duart tua  
Në mërgim të gjerë  
Ne kemi mësuar gjuhën e thashethënëve  
dhe lodhjet e udhëtimit të gjatë  
deri në Ekuator  
dhe gjumin nëpër të gjithë trenat

e zakonshëm e të shpejtë  
dhe dashurinë në limane ...  
dhe ledhatimin e gatshëm për të gjitha llojet e grave  
Ne e kemi mësuar miqësinë e çdo plage  
dhe vëndshkatërrimin e të dashuruarve  
dhe dëshirën e flaktë të të markuarve  
dhe çorbën pa kripë

\* \* \*

- O vend i largët  
A ka humbur dashuria ime në postë?  
Nuk na vie as puthja elastike (e gjatë)  
e as ndryshk hekuri  
Të gjithë vendet janë vendet tona  
Dhe pjesa jonë në to është posta!

\* \* \*

Mos na kujto neve  
Kur kemi dalë nga duart tua  
Në burgje  
Ne e kemi mësuar të qarit pa lotë  
dhe leximin e rrethojave,  
të karierave e të hënës së pikëlluar  
lirinë ...  
e pëllumbin ...  
dhe kënaqësinë që po zhduket.  
Edhe libri i emrave:  
Aishja u përshëndet me burrin e saj  
dhe Aishja jeton ...  
Jetojnë erërat e gjakut, lagështia dhe jasemini!

\* \* \*

- Oj fytyrë e largët  
të vranë në lum,  
por nuk të vranë në zemrën time  
dua të kthesh  
në pamjen tënde të këndshme  
Oj fytyrë e largët!

\* \* \*

Të na kujtosh neve ...  
Kur gjurmojmë nën therrtore  
Dhe le të mbetet ndihma jote  
dominuese ndaj buçitjes së detit  
Dhe gjak në kopshte  
edhe në lindjet tona të reja ...  
Pendë!  
Dhe të mbeten të gjitha zambaqet  
në kopshtin tonë  
Dhe ne jemi ardhës  
Kush blen sot biletë për vdekje  
Pos nesh ... kush!  
Ne i kemi përforcu të gjitha hidhërimet e dynjasë  
Dhe poezi mallëngjimi për atdhe  
As uji i saj nuk gufon  
As dëshira e flaktë e saj nuk kafshon  
E as atdhe nuk ndërton.

Të na kujtosh neve ...  
Ne të kujtojmë ty të gjelbëruar  
të dalur nga çdo gjak

Baltë ... dhe gjak  
Diell ... dhe gjak  
Lule ... dhe gjak  
Natë ... dhe gjak  
Dhe do të të lakmojmë -  
Ti je e dalur nga lumi  
E fundosur në lum  
E ngulfatur në fushën e gjakut  
Gjak  
Gjak  
Gjak ...

\* \* \*

O puthje e fjetur në thikë  
Mollë e puthjeve  
Kush e përmend ushqimin që mbetet -  
Dhe nuk mbeteni -  
Si kopshti i shpresës!  
- Vërtet ne jemi rritur o miskin  
Më tha mua dynjaja.  
- Dhe e dashura ime?  
Nuk rritet vdekja ime  
- Dhe satelitët e mi?  
Ranë me shtëpinë  
O puthje e fjetur në thikë.

A të kujtohet goja ime?  
Unë të dua ty kur të shkatërrojnë  
A kaluan nëpër gjakun tim!  
Si zambaku i cili përvëlon

E dashuroj vdekjen tënde kur më shpie mua  
tek atdheu im  
Si zogu despotik  
O puthje e fjetur në thikë.

Portokalli e zbukuron egzilin tonë  
Portokalli e zbukuron  
E jasemini e zbut ndarjen tonë  
Jasemini është i lirë - i pastërt  
O puthje e fjetur në thikë.

Je vigjilente për të nesërmen  
E vigjilente tashti  
Dhe shpërndahi në bregdetin e zi  
Si era dhe harresa  
O puthje e fjetur në thikë.

\* \* \*

U rrit shpërngulja  
U rrit venitja e lules o dashuria ime vrasëse  
U rrit puna e pa plan në humbjen e  
preokupimit të botës ndaj meje  
U zgjat nata rrugëve të çdo të mërguari  
Jam rritur në çdo anë  
Dhe jam rritur në çdo stinë ...  
Dhe të shoh ty

Largohesh ... largohesh në lumin e largët  
Dhe e braktis bisedën tonë  
Dhe e braktis lëkurën tonë

Dhe e braktis ...  
Dhe ti je festë.  
Dhe të shoh ty  
Drunjtë e hurmave  
Janë rrëzuar.  
Dhe çka tha Abdullahu?  
- Në kohën koprrace  
Shtohen fëmija, kujtimi e emrat  
Dhe të shoh ty  
Çdo dorë klith atje ah  
Ishim të vegjël  
Plçkat ishin të gatshme  
E dashuria ishte lodër.  
Dhe të shoh ty  
Fytyra ime në ty më njeh mua  
Dhe e njeh çdo dashuri  
Nga bregu i madh me zallë  
Ti po largohesh nga unë  
E vdekja është proporcionale.  
Të shoh ty ...  
Të miqësuar me malin e ullinjëve  
në të cilin je dashuruar  
Për erën kalimtare  
Të gjitha rrënjët janë aty  
Aty  
Të gjitha  
Rrënjët  
të qëndrueshme  
Dhe le ta shkatërroj çdo erë forcën  
Në dy sytë e mrekullueshëm

O dashuria ime e guximshme.  
Nuk mbet gjë për qarje  
Mirëupafshim  
Mirëupafshim.  
U rritën formalitetet e të përshëndeturit  
Dhe u humb vdekja  
U humb ...  
Në britmën e lindjes  
Dhe u përhap  
Nga lindja ime deri te arsyeja e shpërnguljes  
Një trup në padrejtësira vrapon  
Si intrigantët e pakuptueshëm.

**AHMED ZAATAR<sup>1</sup>**

Nga lisëna dhe nga guri i përgjakur  
Për ato duar  
Kjo britmë  
Për Ahmedin  
E harruar dhe të vetmuar.  
Retë që vijnë e shkojnë  
Më lanë mua pa atdhe e jabanxhi  
Dhe vetëm mallet kanë guxim  
Që mua të më përqafojnë  
Në një tokë të pabereqetshme.  
Po lindi prapë nga ato plagë të vjetra  
Po futem në tokë  
Deri sa t'ishoh të gjitha detajet tua  
Po lindi prapë  
Vitin që e barti detin  
Nga qytetet të bërë hi  
Ku e kam gjetur veten të vetmuar.

Ahmedi është ai det  
Si shkumë midis plumbave

<sup>1</sup> Tal el-Zatar ishte një kamp palestinez në Bejrut, i cili gjatë luftës qytetare në Liban për dy muaj ishte në bllokadë. Palestinezët përkundër kushteve të vështira kishin rezistuar. Arabisht Talel-Zatar ka kuptimin “mal i lisënës” (bot.Thymus serpillum,Thymus vulgaris) dhe ishte shndërruar në një symbol të rezistencës palestineze. Ahmed Zaatar që është një hero i magjnuar përfaqëson mijëra heronjë palestinez të pa emër të cilët vazhdimisht dëbohen nga vendi i tyre dhe jetojnë në ekzil. Ky hero me emrin Ahmed Zaatar përfaqëson ringjalljen pas betejës dhe rezistencës.

Ishte një kamp që u rrit me mllef  
Lesëna ishte ajo që ra mbi ne  
Dhe Ahmedi u shikoj duart  
Luftëtarëve  
Icili është rritur me kujtimet  
E trenave të humbur  
Me jaseminat  
Që nuk e ka pranuar askush.

Ishte thik në këmbë i vetmuar  
Netëve kur e dëgjonte veten  
Duke vuajtur hasretin e së vërtetës  
Njëzet vjet  
Njëzet vjet ai vend i yti, ky vend i imi  
Ka shëtitur duke pyetur për një identitet  
E që janë përgjigjur vetëm vullkanet.

Unë jam Ahmedi arab  
Tha  
Unë jam plumba  
Unë jam portokaj  
Dhe ëndërra-  
Çadra ime është Talel-Zatar  
Është mëmëdheu im  
Ai udhëtim që shkon në mëmëdhe  
Nga Lindja ederi në Perëndim  
Janë mprehur të gjitha shpatat  
Kur Ahmedi filloi të njoh  
Duart e tij, këmbët e tij  
Si një yll që pikon.

Duke shikuar në Haifa  
Ahmedi ishte kurban i zgjedhur  
Qytetet kanë braktisur pas  
Organet e asfaltit  
I janë vënë pas Ahmedit  
Për ta vrarë.  
Nga Lindja e Perëndimi  
Përkatitej rituali i xhenazes.  
Duke pëlqyer gijotinën nga gijotinat.

Unë jam Ahmedi arab  
Le të vijnë rrethuesit!  
Trupi im kal am  
Le të vijnë rrethuesit!  
Unë jeta ime e zjarrtë  
Do t'i rrethoj ata  
Sepse gjoksi im  
Është strehimore e popullit tim  
Le të vijë rrethimi!

Duke thënë shëtis pranë ujit  
Midis detajeve të imëta  
Fillojnë të shpërndahen  
Bashk me mbrëmjen  
Humbem  
Brenda zërave të këmbanës  
Që vien nga larg.  
Nga vendet e mia që gjakojnë  
E kuptoj që jetoj.

Çdo rrugë në të cilën  
Ikën nga unë  
Ikën  
Çdo qytet në të cilin dashurohem  
Ma hudh sakon time mua.

Mbështgetem në poezitë  
Në ëndërra  
E kuptoj pakaluar shumë kohë  
Se deri tek ëndërrat e mia kishin hyrë thikat.  
E ndezi një qiri  
Nga varra ime e pambyllur  
Sonte  
Veniten të gjithë guralecët.

Dhe gruaja ime e bukur  
Që je diku larg  
Heshtja jote  
E shkriu këtë natë të venitur  
Stazat dhe drynjtë  
Kanë mbetur në hijen tënde.  
Kujtom mua  
Para se ta harroj veten time.  
Ato shkëmbinj janë letra ime  
Në gjithësi.  
Do të ngrihem  
Nga shporta e pemëve  
Nga deti  
Që të ngrihem nga kënga e të mjerit  
Nga kënga e atyre:

Do të jetojmë!

Do të jetojmë!

Ahmed nga lisëna dhe nga guri

Do të ngrihesh

Jo! Duke thënë

Nga thellësia do të japin xhevap

Fshatarët që vijnë nga fusha

Për t'i shporrë zullumqarët.

Grushti im do të bëhet lule

Një bombë

Që gdhin për të thënë jo çdo ditë!

Trupi yt i coptuar nga shpatat

Rishtas do të bëhet

Nga ditët që do të lindin

Dhe do të bëhet niqah me dallgat

Nën gijotinë

Jo! Do të thuash

Jo!

Do të vdesësh me gjakun tim që rrjedh

Për të lindur përsëri

Nga thasët e miellit.

Do të vijmë për t'iu përgjigjur zërit tënd

Atëhere kur të na thërrasësh

Dhe çehreja e vdekjes

Do të zhduket nga fjalët tona.

Dora e vdekjes

Do të na gjuaj neve

Drejt një atdheu lakuriq

Dhe e pret ëndërra jote e jaseminit.

Zogjtë m'lanë këngët tua  
Dhe unë vrapova  
Në arat e rrahjes së zemrës sate.  
Zbrit në thellësitë e gjakut tim  
Zbrit në thellësitë tua  
Për thellësitë tua buka jote  
Qoftë një atdhe i yni lakuriq  
Që e pret ëndërra jote e jaseminit.

Ahmedi i çdoditshëm  
Si i ke evituar ndarjet  
Midis pemës e gurit  
Midis plumbit e drerit?

Arap Ahmed, qëndro!  
Do të shetisim nën rrethim  
Derisa të arrijmë në skajin  
E bukës e të dallgave  
Do të vdesim për ëndrrën  
Për një atdhe  
Dhe për jaseminët që presin.

Atje ka zëra të rrejshëm vjeshte.  
Ajo që ke në gjak poezi është Ahmed.  
Fytyra e përzier sikur malet  
E zërave që thërrasin jehonën  
E trupave të bashkuar.  
Ej Ahmed i panjohur  
Si ke jetuar midis nesh

Plot njëzet vjet  
Hala fytyra jote e paqartë  
Që gjithnjë kemi shetitur vijave  
Të fytyrës së panjohur  
Ej male  
Ahmed secret sa flakët  
Na e trego fytyrën tënde  
Thuaje fjalën tënde të fundit  
Do të shpërndahemi në heshtje  
Do të bëjmë hapin prapa që të vdekuritt'i dëgjojnë  
fjalët tua  
Të gjallit  
Ndoshta i njohin vijat tua.  
Ahmed  
Vëlla Ahmed  
E presim vdekjen tënde heroike  
Kur?  
Kur?  
Kur?

**I DASHURUARI NË PALESTINË**

Sytë tu një therrë  
E ngulitur në zemër  
Të atij që dashuron marrëzisht  
E që s'mund ta durojë torturën e saj.  
Sytë tu një therrë  
Që e kam mbrojtur nga era  
Që e kam futur thellë  
Përtej vuajtjeve, netëve.  
Kandilat digjen me dritën tënde,  
Netët shndërrohen në agim.  
Kurse unë harroj përnjëherë  
-sapo sytë ndeshen me syun-  
Në një kohë kur kemi jetuar  
Bashkë derë më derë.

\* \* \*

Duke folur sikur cicërimë,  
Edhe unë do të doja të flas.  
Po a ka mbetur diçka e mirë në buzët!  
Në ato buzë si pranverë!  
Fjalët tua  
Si pëllumb  
Flutuaruan  
Nga foleja ime.  
Dera jonë,  
E verdhë sa vjeshta

Mori turr shkallëve  
E shkoi  
Atje ku deshti shpirti im.

\* \* \*

Pasqyrat u bënë copa copa,  
U derdhën në shpirtin tonë  
Dhembje mbi dhembje.  
I mblodhëm pluhrat e zërit  
I sollëm në një vend.  
Kështu kënduam  
Këngën e dhembshme të atdheut tonë.  
Të gjithë bashkarisht  
E kënduam me saz këtë këngë.  
E gjuajtëm këtë këngë  
Sikur kur gjuan gurë në oxhaqet e shtëpive  
Merrene i thamë,  
Zemrave që tunden nga dhembja.  
Ndërsa çdo gjë e kam harruar unë tash.  
Po ti, po ti, e dashur,  
Që zërin nuk ta di askush!  
Ndoshta është shkuarja jote  
Apo është heshtja jote ajo që e ndryshk sazin.

\* \* \*

Dje të kam parë ty në liman,  
Udhëtar i vetmuar e pa ushqim për rrugë.  
Vrapoja drejt teje sikur një jetim,  
Thuaja se kërkoja nënën time plakë.  
Si, si mundet që një dru i njomë portokalli

Të mbyllet në një qeli apo në një liman,  
 Si fshihet gurbeti në dorë  
 Dhe të mbetet krejt i gjelbërt?  
 Shkruaj në notesin tim:  
 Jam stacionuar në liman...  
 Dynjaja ishte sikur sytë e ftohtë  
 Që janë më të ftohtë se acari i dimrit,  
 Duart tona ishin përplot lëvozhga portokalli.  
 E mbrapa meje ishte gjithnjë shkretëtirë,  
 Gjithnjë shkretëtirë  
 Gjithnjë shkretëtirë.

\* \* \*

Ty të kam parë në malet e pjerrët,  
 Vajz çobani me qingjat tu që i ndjek.  
 Ti ishe kopshti im, në mesin e rrëtimeve  
 Unë isha ai jabanxhiu, unë isha  
 Ai që troket derën tende.  
 Ej zemër! Ej zemër!  
 Dera ngrihej mbi zemrën time,  
 Dritaret, gurët e çimento  
 Mbi zemrën time.

\* \* \*

Ty të kam parë në testitë e ujit  
 Në kallinjte e grurit,  
 Të rrënuar, të bërë copa copa.  
 Të kam parë duke shërbyer në klubet e natës  
 Të kam parë në shkrepëtimat e dhembjeve dhe në plaga.  
 Pa bërtitur të ishte shkëputur një pjesë e mëlçisë

Ti do të bëhesh erë e buzëve të mia.  
Ti je zjarr e ujë i pijshëm  
Të kam parë ty në grykën e një shpelle  
Duke i shtrirë teshat e jetimëve.

Të kam parë ty në sokaqe dhe në oxhaqe  
Në gjakun që vlon në diell.  
Edhe në shtalla...  
Dhe në të gjitha kripat e detit.  
Dhe në rëra  
E bukur si toka!  
Si jasemini  
E si fëmijët!

\* \* \*

Dhe betohem se  
Do ta qendisi një mendil deri nesër  
Të stolisur me poezitë që ia kushtova syve tu  
Dhe me një fjali, më të ëmbël se  
Mjalta e puthjet  
“Kishte një Palestinë,  
Përsëri ka një Palestinë!”



Shënimi i katalogut CIP të këtij libri ndodhet në  
Bibliotekën Kombëtare Universitare "Shën Kliment Ohridski", Shkup

821.411.21'06-1

821.411.21'06-1.09 Dervish, M

DERVISH, Mahmud

Poezi për rezistencë dhe liri / Mahmud Dervish ; e përktheu nga  
arabishtja Abdullah Hamiti. - Shkup : Logos-A, 2013. - 176 faqe. ;  
21cm. - (Biblioteka Divan)


Titulli i origjinalit në gjuhën arabe: - Kasaid lil-Mukaveme ve-l-Hurrije -  
Mahmud Dervish, poet i identitetit dhe i rezistencës palestineze /  
Abdullah Hamiti: faqe 9-19

ISBN 978-9989-58-474-9

a) Dervish, Mahmud (1941-2008) – Poezi – Kritika dhe interpretime  
COBISS.MK-ID 93779466

**[www.logos-a.com](http://www.logos-a.com)**

Copyright©Logos-A, 2013



LOGOS·A